

INTERVISTË ME GRETA KAÇINARIN

Prishtinë | Data: 28 shtator, 2020

Kohëzgjatja: 249 minuta

Të pranishëm:

1. Greta Kaçinari (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Gretë, a mundeni me na jep një biografi të shkurtër edhe me na tregu prej çfarë familje vini? Çfarë prejardhje keni?

Greta Kaçinari: Unë jam Greta Kaçinari, mirë se keni ardhë në banesën time (qeshë).

Anita Susuri: Mirë se ju gjeta.

Greta Kaçinari: Dhe kam lindur në Prizren në vitin '47. Vija nga një familje pesë anëtarëshe. Profesionit i babës ka qenë argjentar. Unë jam fëmija i parë, përndryshe i kam pasë edhe dy vëllezër, të dytë janë tash të ndjerë, normal edhe prindtë. Dhe si fëmijë më kujtohet një thënie nga Dhjetë Urdhërimet që janë në Bibël, e katërta është, “Dëgjo prindin tënd ndaq me jetë shumë përmbi dhë”. Kështu është në gjuhë të vjetër e shkruar. Dhe po duket se falë kësaj unë edhe kam arritur në këtë moshë, jam e vetmja që kam mbetur prapa tyre. Ka edhe normal edhe anëtarë tjerë të familjes të vëllezërve, po ja që unë jam ajo që kam arritur këtë moshë të cilën e kam.

Përndryshe, si fëmijë i parë më kujtohet, prindërit asnjë hap nuk e bënin pa mua, në dasma, në ahengje, në festivitete të vitit të ri... ju e keni një fotografi, e keni pa [i drejtohet intervistuesës]. Domethënë, si fëmijë i vogël vazhdimisht kam qenë me ta. Pastaj, nuk e di, ashtu, më vinin mbi tavolinë unë luaja, vallëzoja, këndoja. Pastaj, baba ishte i angazhum në trupën e amatorëve të Teatrit të Prizrenit. Pasi i kishte musteqet e zeza në shfaqje e luante Hitlerin edhe në shumë komedi të tjera.

Unë, normalisht tash nuk i kujtoj ato, por më kujtohet se mua më patën vu ta recitoj një vjershë sepse baba punonte si filigranist në Filigranin e Prizrenit të atëhershëm dhe e pat thurë një vjershë të vogël të cilën ma dha mua që ta recitoj para se të fillonte... në Teatrin e Prizrenit. M’i patën ble rrobat kombëtare si të Prizrenit, dimi, jelek, ato bluzat e bukura të mëndafshita edhe një kurorë mbi kokë edhe unë e pata recitu atë vjershë. A ta them?

Anita Susuri: Thuaje.

Greta Kaçinari: {reciton} “Argjendare kam qillue, një brosh të vogël me mbarue dhe në zemër për me vnue. Kur kom qenë n’koperativë i kam pa njerz të tu punue, tu i ba lacra, tu i ba zogj, t’u qeshë, t’u mahitë ju shkon dita për dakik”. Edhe ja këtë... këto janë segmentet e jetës të cilat më janë ngulitur në

kokë, ka edhe shumë ngjarje tjera po.... Falë kësaj që edhe në korzo kur dilnin, mua për dore në mes. Korzoja e Prizrenit, shëtitörja e Prizrenit ka qenë e famshme atëherë, mendoj që ka qenë edhe tash njerëzit shëtisin sikur në sheshin këtu në Prishtinë. Unë isha ndërmjet atyre dyve dhe kjo disi ka qenë një përkrahje, ndoshta prindërit s'kanë qenë as të vetëdijshëm, se në mua kanë ngulitur një vetëbesim që pastaj gjatë jetës sime kjo më ka ndihmuar shumë.

Anita Susuri: Zonja Greta, deshta me ju pytë si e kujtoni ju Prizrenin atëherë? Si e keni pa si fëmi?

Greta Kaçinari: Prizreni, unë kam jetue në rrugën që lidhte gjimnazin e vjetër, Gjimnazin e Prizrenit edhe rruga, atëherë quheshte Bihačka, lidheshte me Bistricën e Prizrenit. Një rrugë shumë interesante e përbërë prej shumë llojeve të njerëzve, një kujtim shumë i bukur. Në fillim të rrugës ishte një familje katolike, pastaj ishin, ishte familja e bektashive, pastaj një familje e serbëve, pastaj ma tutje prapë një familje ta marrim katolike, më kujtohet e kishim përballë. Mandej një familje gjakovare, pak më poshtë ka qenë një familje turke.

Ashtu që, ka qenë një rrugë... edhe unë si fëmijë e flisja turqishten, përpos kur jemi shpërngulë, ajo ka, po mendoj nuk e kam përdorë më tutje. Por baba po, e fliste shumë rrjedhshëm. Unë shumë mirë e kuptoj, pak komunikoj. Domethënë, është një pasuri që njeriu, Prizreni si qytet ku unë veten e kam ndje gjithmonë ngrohtë edhe e kam ndje vetën e madhe, edhe pse e shkurtë me trup për shkak shtëpive të vogla, unë e ndjeja vetën të madhe, të madhe, të rritur, taman ashtu, jo ndryshe nga të tjerët... po flas për kohën e Rankoviqit domethënë të viteve të '50-ta.

Kur vinin ata, baba tanë natën nuk ishte në shtëpi edhe unë e pata pytë nanën, "E ku është baba?" Se bacë i kam thanë, "E ku është baba?" "Ka shku me luftë letrë". Në të vërtetë çfarë ka ndodhë, e gjithë gjenerata e tij që kanë qenë në ushtri e kanë pasë të shkruar në librezën e ushtrisë, "I papërshtatshëm" "*Nepodoban*" edhe sa herë, domethënë që ka pasë vizita i grumbullonin këta "*Nepodobni*" këta që ishin të pa përshtatshëm dhe i futshin për 24 orë, ka ndodhë edhe ma gjatë, në burg, në biruce.

Anita Susuri: E pse kanë qenë të papërshtatshëm?

Greta Kaçinari: Kjo ka qenë sepse, ka qenë një politikë shumë e veçantë e asaj kohe që të bahet, të bahen presione të tërthorta, jo të drejtpërdrejta, të tërthorta që njerëzia të shpërngulen. Dhe tash po ju them, në kohën e shpërnguljes të shqiptarëve të fesë muslimane që kanë shkue në Turqi, në të njëjtën kohë ka qenë presion ndaj shqiptarëve katolikë, të cilët po ashtu viteve të '50-ta në mënyrë pak ma herët ka fillue, domethënë para viteve të '50-ta kanë qenë familjet e para të cilat janë shpërngulë. Edhe ata janë vendosur anëmbanë ish Jugosllavisë. Përndryshe, shumica prej tyre, qoftë argjendarë, qoftë... shumica prej tyre argjendarë. Në të vërtetë, jo shumica, po krejt.

Po e them këtë sepse ma vonë kontaktet me të gjithë këta njerëz nuk kanë mungue asnjëherë. Domethënë, kanë qenë vizitat familjare, vizitat miqësore, vizitat, kudo qofshin apo kudo kemi qenë. Një periudhë mjaft e dhimbshme, e këtë po e them me mjaft përgjegjësi sepse ma vonë në Tuzëll, në Bosnje ku kemi jetue ka ardhë një çift bashkëshortor, sepse në atë kohë politika e atëhershme ka qenë që t'i mbrojmë edhe njerëzit e vet. Domethënë, ata që e kanë krye një detyrë të caktuar i kanë shpërngulë në një vend tjetër, dhe na nuk do të dinim krejt këtë po të mos ishte ky çift bashkëshortor, Ristiç, të cilit erdhën për të jetuar në Tuzëll edhe të jetë pastaj ajo *çika* [Srb. xhaxhi] Aca, babës i pat tregu në hollësi se pse ka ndodhë krejt kjo.

Edhe më kujtohet ai moment, kjo ka qenë pas disa gotave raki kur ai është hapë dhe i ka thanë, “Prej sotit ti ma nuk duhesh ta shkelësh pragun e shtëpisë sime”. Ishte vërtetë, po mendoj, pasojat e asaj janë evidente edhe sot, se shumë prej këtyre familjeve kur ndodhën edhe të gjitha luftërat në ish Jugosllavi edhe këto familje kanë marrë rrugë tjera, janë shpërngulur, qoftë në Kana... në të gjitha anët e botës. Është... mund të them që kjo nuk ka ndodhë vetëm në Prizren, ka ndodhë edhe në Pejë, edhe në Gjakovë, edhe në Ferizaj, në të gjitha vendet ku ka pasë ndikim politika e atëhershme për shpërnguljen e shqiptarëve.

Dhe ja, t’i kthehem edhe pak Prizrenit dhe erës së Prizrenit që më ka udhëheqë tërë jetën më vonë dhe që ka ndikue që... nana ime këndonte shumë bukur, ishte anëtare e korit të kishës edhe unë i dëgjoja ato këngë, jo vetëm kishtarë po këndonte shumë bukur, i këndonte edhe këngtë e vjetra, këngtë popullore edhe që ma vonë ato kemi vazhdu t’i këndojmë edhe atje ku jemi shpërngulë. Ashtu që, përmes këngës e kemi rujtë edhe gjuhën, atë gjuhë që e flisnim në Prizren, prizreniancshe, “A po vish, a po dish, a po shkojsh”. Me turcizma, pa e ditur se po flasim me turcizma, shembull, te ne kur na kanë ardhë mysafirtë ne kemi thënë, “*Hoşgeldin*”. Këto kanë qenë. Edhe kto na i kemi marrë të gjitha me vete dhe kemi...

Unë për veti kam kujtu që gjithmonë ashtu duhet të pres miqtë shqiptarë që na vinin në vizita. Derisa një herë ka ardhë një që e kryente ushtrinë në Tuzëll dhe thotë, “Çka kjo? Qysh po thu *hoşgeldin*?” Une po i thom, “*Hoşgeldin* de”. Ai po thotë, “Duhet me thanë mirëseerdhe”, une po thom, “Uuuu, shumë e komplikume”. Po ishte e komplikume, si tashti une ta ndrojoj zakonet e shtëpisë sime për një fjalë që ai donte t’na impononte, për mua ishte imponim atëherë. Por, sidoqoftë kjo me *hoşgeldin* ka qenë... keni mujtë me dëgju në Rijekë, në Zagreb gjithkund. Mikëpritja e familjeve që vinin në vizita ose shkonin në vizita ka qenë me këtë shprehje. Prizreni ka pasë këto të bukura.

Anita Susuri: A ka qenë, për shembull në Prizren me u dallu me nifare forme kush është shqiptar, katolik, kush është serb? A janë dallu disi? A është pa kjo te njerëzit apo kanë qenë të barabartë t’gjithë?

Greta Kaçinari: Dallimi ka qenë vetëm në veshje. Mu më kujtohet si fëmijë, se ende ishim me ato llampa me vajguri, domethënë mbaj shumë mend se, po të gjitha këto janë si segmente, si pjesë të filmit. Aty ku jetonim ne, në kojshi kemi pasë një familje Gjakovare, Xharra, me ata flisnim shqip edhe me totën Palinë që ishin përballë neve edhe me të shqip. Por, kur vinte, Nusreti atëherë baba me të fliste turqisht. Me ato familjet serbe flisnim alla vranjançe¹, “*Što praviš mori?*” [Çfarë po bën mori?] “*Ete, perem draske*” [Ja, po i laj dërrasat] {bën sikur lan diçka me duar} edhe kështu në këtë mënyrë.

Pse po e them këtë? Njerëzit kanë komunikue mes vete në cilëndo gjuhë, të gjithë i kanë folë të gjitha gjuhët. Nëse nuk i kanë folë i kanë kuptue edhe ashtu që komunikimi ka qenë shumë njerëzor. Është një këngë të cilën e mbaj mend, e cila më vonë është këndue në shumë ahengje kur si e rritur kam qenë prezente nëpër dasma, nëpër shumë takime për 28 nëntor, se e festonim ne 28-tshin... po e festonim edhe kërkush nuk e dinte që është 28-tshi se vinte 29-shi menjëherë, festa tjetër që ishte zyrtare [e Jugosllavisë].

Edhe është kënga, nuk mundem pa e thënë, nuk e di a e mban në mend edhe dikush tjetër përpos meje, ma merr menja se po. “*Ala imaš gajtan vegi. Avdi ago, more Avdi ago*” a ta këndo?

¹ Të folurit e qytetit të Vranjës në Serbi.

Anita Susuri: Këndoje, pse jo.

Greta Kaçinari: {këndon} “*Ala imaš gajtan vegi, Avdi ago, xhanëm Avdi ago, ti gumrije, xhanëm fol me mue, aman zbori sa s mene, kiz mori söyle benimle*” (buzëqeshë). Edhe, si mos me e dashtë Prizrenin? Kjo është kjo. Një, këto i këndonim edhe shumë kangë të tjera, kur nuk kemi bo dallim cilën po e këndojmë vetëm tonaliteti cili është lidhë njëri pas tjetrit. A u këndu shqip, a u këndu turqisht, a u këndu serbisht s’ka pasë dallime. S’paku po flas për familjen time edhe për të afërmit e mi edhe për miqtë, të cilët i kemi pasë ane mbanë ish Jugosllavisë me të cilët kemi pasë kontakte të shumta. Edhe sot kemi kontakte, po jo më fizike pasi jemi ku jemi dhe pa mundësi të lëvizjes. Ashtu, kjo do të jetë një temë tjetër ku do t’ju tregoj...

Edhe një element interesant dua t’ju tregoj se kur ka lindë vllau i dytë, pas meje, unë isha shumë e vogël por i shifsha, edhe këto më kanë mbetë në kujtesë, nana e kishte në gji por një ilaka [kushëri] ka ana e babës iu pat shterrë gjiu dhe fëmia i cili ka lind në të njejtën kohë me vëllaun tim, i cili sot është gjallë edhe jeton këtu në Prishtinë, nana e ka ushqye barabar edhe atë fëmijë. Po, a ka më kshu? Jo. Domethanë, lufta për ta mbrojtur atë qenie që e kanë prue në jetë edhe kjo mua më fasionon të të gjitha ato gra që veprojnë në këtë mënyrë. Nuk e di, nuk besoj se sot veprojnë, gratë moderne me siguri jo, janë kohna tjera. Por ja shembull shumë njerëzor, shumë i bukur, shumë i dashtun.

Anita Susuri: Zonja Greta, a iu kujtohet shtëpia juje parë si është dukë?

Greta Kaçinari: Shtëpia në Prizren? Po qysh s’më kujtohet. Shtëpinë e kishim përdhesë dhe kati. Në kat ishin dhomat e fjetjes, përdhesë ishte dhoma, mos t’a them dhoma e ditës se ishte hyrja, ishte magjja e madhe dhe hyrja e kësaj dhome u mblidheshim të gjithë, dhe ku ishte edhe një tangar, e dini se çka është tangari?

Anita Susuri: Po.

Greta Kaçinari: Mirë.

Anita Susuri: Po ju shpjegoni nëse doni, ndoshta dikush nuk e din.

Greta Kaçinari: Po si ta spjegoj, është një enë dheu, vatër po. Enë e madhe dheu në të cilën ruheshte zjarri edhe aty gjithmonë me... prej druve apo, zjarri ruheshte për të nesërmen për ta ndezur këtë, gati thashë kaminin (qeshë) oxhakun. Edhe këtë e bënte gjyshi. Gjyshi jetonte me ne edhe gjyshi im e ka pasë edhe vreshtin, jo, të mbes te oborri një herë. E kemi pasë një oborr të madh nëpër të cilin kalonte potoku. Të gjitha shtëpitë e Prizrenit kanë qenë të lidhura me potoqe ku kalonte... unë nuk e di çfarë sistemi ka qenë ky, por mendoj që edhe sot e asaj dite ndoshta ka ende shtëpi që, përmes të cilave rrjedhë potoku. Potoku e ndante oborrin në gjysmë.

Normal kemi pasë shumë lule, gjyshi mbjellte në një pjesë qepë, domate, patate, kjo më kujtohet edhe e kishim një dud shumë të madh të cilin unë e adhuroja se më pëlqenin dudat. Edhe kur vinte koha për me shkund dudin, me çarçafa të bardhë vinin kojshitë me na ndihmë për me e shkund edhe ajo pastaj ndaheshte edhe ndaheshte me të tjerët. Një kohë, domethënë kur isha shumë e vogël, se po e them këtë se më ka mbetë në kujtesë, gjyshi e mbante një dhi dhe posa e mjelshin atë dhi, domethënë unë kam qenë ndoshta tri vjeçare, ashtu tasin e ngrohtë të qumshtit ma jepshin për me e pi dhe unë jam rritë me qumësht dhie, jam rritë në një periudhë shumë të shkurtër.

Edhe më kujtohen edhe shkuarjet në vreshtë, vjelja e rrushit dhe mu më hypnin me një, me ma... gomar zakonisht edhe me sepeta të mdheje e bartnin rrushin. Gjyshi pastaj e nxjerrte kazanin dhe piqte

raki. Edhe ka ndodhë që kam shku edhe e kam mbushë ni tas... rakia kur është posa e pjekur është shumë e ëmbël, e nxehtë dhe unë e kam pi dhe për herë të parë në jetë jam (qeshë) kam qenë ashtu tamam e pitë edhe më kujtohet çdo gjë më shkonte rrotull. Nana e baba ishin të trishtuar (qeshë), “Kuku, çka ka ndodhë?” Gjyshi, “Jo, jo. Une s’ia kom dhanë”. Ai i shkreti. Por, e kam dashtë shumë gjyshin.

Unë kam fjetë atë natë, të nesërmen kur jam çu e kemi pasë ni pasqyre që rrinte e mbështetur në dritare dhe e kam pa vetën shumë të bardhë edhe kam dëgju se ka vdekë vajza hallës, një vajzë e vogël, posa ka lind ka vdekë. Edhe unë tash fjala vdekja për mua ishte se duhet me qenë i bardhë edhe unë shkoj te gjyshi i them, “Gjysh, une kam me vdekë”. Edhe gjyshi, i shkreti, e len kazanin e len rakinë edhe shkon te halla, te shtëpia e hallës dhe ju tregon se qishtu po ndodhë.

Unë kam harru çka i kom thanë gjyshit, kam dalë para dere në rrugë edhe t’u lujtë, kur po i shoh gratë, gratë me dimi t’u nga. {Shpjegon me duar mënyrën e vrapimit} Kështu po baj sepse ishin mjaft të bashme dhe vraponin, “Kuku, çka ka ndodhë?” Shpejt më marrin më vendosin mbi një tavolinë mbi oborr që ishte edhe atëherë. Vjen kojshija, Xharra, kojshia, ai Kuzhi e ka pasë mbiemrin. Edhe ai e kishte ni allti mrapa sepse punonte në, nuk e di ku ka punue, por e di që e mbante alltien gjithmonë, revolen e mbante. Edhe unë kam thanë, “Kuku, ky ka ardhë me m... deri në fund t’mos mundohem shumë”. Edhe kjo ka qenë tmerr për mua.

Mandej ma kanë dhanë një gotë qumësht të dhijes edhe ashtu kam pushu. Është interesant se si mbesin në kujtesë edhe fytyrat e njerëzve që ishin aty. Mandej, më kujtohet edhe diçka, telat që ishin, për me i varë teshat, përpara kanë vendos tela për me i varë teshat dhe ishim t’u lujtë te kjo familja gjakovare me fëmijët e tyre, edhe sot më kujtohen emrat e tyre, Kujtimi, Lumja. Edhe unë nuk e di se si, por e kam kap njërin tel me dorë e ai ka qenë me rrymë. Ka qenë tmerr ka qenë. Atë më ka zënë, më ka dridhë.

Më ka dridhë rakia, më ka dridhë rryma (qeshë). Por, ajo që shëtisnin me mua mes prindërit e mi, pa marrë parasysh këtyre dridhjeve, kishte edhe, kishte edhe vetëbesim apo luftoja. Edhe drejt kam shkue në potok, në ujë pas asaj. Në të vërtetë më kanë kap prej aty edhe më kanë vu në ujë, të jem te dheu dikund që të shkon rryma prej meje. Prej asaj dite e deri më sot kurrë nuk e kam dashur dhe shumë i frikësohem, palidhje.

Edhe pse ma vonë kam qenë mjeshtër i hekurave, ujtive përpara që kanë mund të rregullohen ato në shkollë fillore i pata mësu ato kur kemi jetu në Tuzëll. Edhe, domethënë oborri shumë i bukur edhe shumë mirë e mbaj në mend kohën e pranverës kur lyheshte muri me të bardhë dhe poshtë me atë pjesën e zezë qoftë brenda oborrit qoftë në rrugë, domethënë krejt gratë e shtëpive përreth dhe përballë që ishin, ishte dita kur lyheshin muret edhe ajo më e bukura është kur e stërpikshin atë të zezën edhe ishte shumë dekorative. Qe kta, edhe kta si film e mbaj mend ashtu si një segment...

Anita Susuri: A kanë qenë edhe shtëpitë e juja në stilin otoman sikur në Prizren qysh kanë qenë apo janë dallu, për shembull shpitë e katolikve...

Greta Kaçinari: Jo, jo. Ka qenë një shtëpi e rëndomtë, nuk dallonte prej Xharrave apo prej tjerëve. Po mendon prej atyre tavanave...

Anita Susuri: Stili si ka qenë për shembull?

Greta Kaçinari: Jo, i kemi pasë dritaret të rëndomta. Domethënë, nuk ka qenë shtëpi e kohës së Turqisë, po ka qenë shtëpi e ndërtume ma vonë të cilën unë nuk e di, unë kam lindë aty. Nuk e di se si, e di që gjyshi i ka kalu nja dy vjet në Amerikë e është kthyer, kjo një çështje tjetër. Ma vonë e ngucshin, e pytshin qysh flasin amerikanët? Ai tregonte, “*How much an egg?*” “Sa kushtojnë vetë?” (qeshë).

Anita Susuri: E pse ka shku gjyshi ju? Me punu apo?

Greta Kaçinari: Shkonin atëherë në atë kohë, në kohën e gjyshit, në kohën e gjyshit. Tash kjo kohë pak ma e hershme, domethënë para Luftës së Dytë Botërore edhe ma herët edhe... Derisa jam te gjyshi, gjyshi këndonte shumë bukur. Ka pasë një za interesant, tash më duket interesant, por këngët që ai i ka këndue une edhe sot e atë ditë i die. Domethanë, janë këngë të vjetra të cilat tash po shoh nganjëherë po i dëgjoj se po përtërihen, për shembull ai e këndonte një këngë të hakmarrjes, osmanlika, osmanlitë apo osmanlika. Atë kangë e di prej A deri në Zh, kurrë s’e kam harrue sepse e kam këndu se më ka pëlqye gjithnjë.

Pastaj Destan Begu e kto janë ato kangë. Kurse babës i pëlqente Hajredin Pasha, qysh me mësu Hajredin Pashën. Hajredin Pasha është ma vonë kur kemi jetu në Tuzëll, atëherë e dëgjonim nganjëherë qoftë që i dëgjonim në dasma qoftë pllakat e gramafonit që i blinim, e kishim Qamilin e Vogël edhe plot të tjera kshtu por ai e donte Hajredin Pashën. A të mbes ende në Prizren?

Anita Susuri: Si të doni ju, për neve s’ka problem.

Greta Kaçinari: Domethënë, klasën e parë kam qenë gjashtë vjeçare, kur i kam mbushë gjashtë, gjashtë i kam mbushë me, në maj, në shtator kam hy në klasën e parë dhe më kujtohet se mësuesi në fund të vitit shkollor kemi fitu libra, libër për sukses. Edhe unë i kam fitu tre libra, kam arritë t’i fitoj të tretë. Të tretin nuk e kam marrë drejtpërdrejt, po ia kanë dhanë hallës time dhe ajo pastaj kur kemi ardhë në vizitë në Prizren ma kanë dhanë atë libër. Nuk i kam rujtë ato libra për fat të keq.

Pjesa e Dytë

Greta Kaçinari: Pa, me thanë, pa i mbushë, pa e krye diku në prill të vitit ‘56, pa i mbushë të nantat, unë si nantë vjeçare, vëllau ishte gjashtë e ai ma i vogli ishte tre vjeç. Atëherë baba ka shku në ‘54-shën në Bosnje, në Tuzëll edhe axha edhe ata derisa janë adaptue pak, derisa kanë fillue punën në që të kenë mundësi të hapin dyqane edhe kanë hapë dyqane që të dytë, atëherë ne, ka ardhë, ka kërku me letra atëherë shkruheshin që edhe ne të shkojmë. Edhe ne në ‘54-ten, në prill, domethënë pa e krye klasën e tretë kemi shkue në Bosnje, në Tuzëll të Bosnjes. Dhe atje fillon një etapë e re e jetës sime.

Anita Susuri: Qysh e keni marrë ju këtë lajm që po shkoni? Si iu është dukë juve?

Greta Kaçinari: Po, së pari ka qenë shumë interesant për shkak se ishte udhëtimi në pyetje. Udhëtonim prej Prizrenit në Ferizaj me ata autobusat me gjysmë hunde, autobusi më kujtohet, nuk e di mund t’i shihni në filma shumë të vjetër dhe më kujtohen kthesat shumë të mëdha në Qafë Dule, Dulen. Atëherë ishte rruga e vjetër, për të mbërri në Ferizaj. Pse në Ferizaj? Në Ferizaj ishte stacioni i trenit, ne duheshim të udhëtonim me tren.

Anita Susuri: E në Prishtinë atëherë nuk ka qenë?

Greta Kaçinari: Jo, jo. Prishtina s'ka qenë, ka qenë kasaba. Ndoshta me dy, tri ndërtesa të ndërtume aty në sheshin e sotëm Nënë Tereza. Nuk e di Prishtinën të asaj kohe. E di Prizrenin, e di Gjakovën, e di... i di disa fshatra të Gjakovës, Doblibarën, sepse atje ishin dajtë, dajtë, dajë mas dajve, dajtë e babës. Dhe s'e harroj kurrë, na kanë thirrë me një darsmë, kemi shkue me qerre të bullicave edhe është deshë ta kalojmë, ta kalojmë, nuk e di cili lumë, duhet t'jetë, nuk e di, një lumë është deshtë ta kalojmë si fëmi unë në qerre me prindtë, dhe bullicat janë kthye në një anë sepse ka qenë mjaft i thellë uji. Dhe më kujtohet frika që ishte atëherë, sepse u friku nana shumë edhe normal edhe ne.

Por më kujtohet oborri i asaj shtëpie me ato mure të mëdha që ishin nëpër katune dhe më kujtohet qilari, qiler, qileri i tyre me pjata me sahana të drurit ku ruheshte qumështi. Këto janë krejt ato që më kanë mbetur në kujtesë dhe tupanxhiu dhe plaka e shtëpisë apo zoja e shtëpisë e cila vallëzonte me tupan. Këtë s'e harroj kurrë. Ajo vet vallëzonte edhe... nusët asnjëna, Zot mos, në atë kohë nuk ka pasë mundësi të bëhet kjo. Por këtë nuk e harroj kurrë e veshur me tesha kombëtare edhe para tupanit, shumë bukur, tepër bukur. Pastaj i hypëm atij autobusit me gjysmë hunde, pjesa e përparme ishte vetëm gjysma dhe hypëm në tren. Për të arritë në Bosnje kemi udhëtue...

Anita Susuri: A ka pasë prej Ferizajit direkt për Bosnje?

Greta Kaçinari: Jo, jo, çfarë. Duheshte ma së pari të shkonim në Beograd, pastaj rrotull të shkonim në një vend tjetër në lindje të Bosnjes në Doboj, e prej Dobojit pastaj prej këtij vendi pastaj ka qenë treni për në Tuzëll. Domethënë, sa stacione po i bje me i kalue. Edhe krejt kjo me ata trenat të ngadalshëm që ishin në atë kohë.

Anita Susuri: Sa ka zgjatë udhëtimi përafërsisht?

Greta Kaçinari: Nuk e di, nuk e di sa ka zgjatur por duhet të ketë zgjatur shumë. Ndoshta dy ditë udhëtimi për shkak të pritjeve në stacione. Edhe atëherë kemi mbrrie në Tuzëll e në Tuzëll tash fillon një etapë e re e jetës time. Domethënë, po vijmë në një qytet ku flitet një gjuhë tjetër, pa marrë parasysh njohurive të gjuhës serbe alla perzeriançe. Domethanë, nuk kishin të bënin njena me tjetrën, dallonin shumë. Dhe më regjistruan në klasën e katërt. Fati im ka qenë shumë i madh sepse ishte një mësuese më e moshuar edhe e cila që nga fillimi më ofroi shumë. Unë falë kësaj pastaj kam praktikue shumë gjëra më vonë në profesionin tim. Dhe ajo më ofron e tash pasi unë dija të vallëzoja, të këndoja, por me gjuhë nuk i kisha puntë shumë mirë.

Për shembull, ka ndodhë me thanë nëse ni herë më kanë ngacmue mjaft dhe unë kam thanë, “*Sad ću da donesem moju mamu*” [srb.: Tani do ta sjellë nënën time] {bën si e nevrikosur} *donesem* domethënë do ta bartë, jo do ta sjellë por unë kam thanë do ta bartë sepse atë fjalë e kam ditë. Edhe ata kanë fillu të qeshin edhe unë pastaj i kam mbledhë pak mendtë edhe kam fillu të mësoj, të lexoj mirë dhe nganjëherë edhe ajo çka na përqeshë në jetë na shtyn që të bëjmë një hap tjetër për me tregu që gabim jeni, unë nuk jam ashtu qysh po mendoni ju. Edhe pasi, kur u krye kjo klasa e katërt, atëherë

pasi këndoja, vallëzoja e kishim defin, unë i kisha dimitë, i kemi marrë sendet me vete, të gjitha. Pasuria në Prizren ma vonë është shitë edhe nda me axhën.

Atëherë kjo mësuesja më angazhon në programin shkollor edhe më kujtohet në skenë me dimije me jelek e veshun, me def, edhe e kam këndue “Ani krisi pushka”, ishte kanga. Pse “Ani krisi pushka”, se këtë kangë e dinin të tjerët prej një filmi që ishte i asaj kohe, “Kapiten Lleshi” ka qenë filmi. Filmi s’më kujtohet më por e di që këtë këngë e dija, “Ani krisi pushka”. E unë t’u këndu, t’u vallëzu në skenë hu vetëm. Edhe atëherë dija t’i bija deficit e sot nuk e di a kisha mujtë ta bëjë këtë.

Normal baba e pat ble një banesë shumë të madhe, ne jetonim, muajt e parë kemi jetu në dhomën mbi dyqan e pastaj jemi shpërngulë në një shtëpizë shumë të vjetër, po kto ishin në kto filltet. Dhe aty më kujtohet e kam pasë një shoqe që ka qenë, një shoqe hebreje. Edhe Bosnja, edhe Tuzla ka qenë një qytet për shkak, se ka qenë qytet industrial, një qytet i përbërë prej shumë, shumë i llojllojshëm për sa i përket qoftë nacionalitetit, qoftë përkatësive të ndryshme, çka s’ka pasë në atë qytet. Domethanë prej ni qyteti, ta quaj laraman, po vi në një qytet tjetër po shumëfish i larmishëm në këtë kuptim. Ashtu që, kjo të mëson t’i duash njerëzit e tjerë, thjeshtë të tillë siç janë.

Anita Susuri: E shoqja juaj hebreje a ka qenë aty gjithmonë apo pas Luftës së Dytë Botërore ka...

Greta Kaçinari: Ajo ka jetu aty. Unë atë e kam gjetë aty në Tuzëll, pastaj ata kur u formue shteti Izraelit ata kanë shkue në Izrael. E ka pasë edhe një vlla të madh e kjo ka qenë e moshës sime. Janë shpërngulë pastaj prej atyhit. Na mandej na dhanë, komuna na dhanë një banesë një dhomëshe diku ma larg qendrës së qytetit. Shtëpinë, banesën që e pat ble baba ka qenë në qendër të qytetit, po ishte e banune me banorë të tjerë. Tri familje kanë jetu në atë banesë që ishte pesë-gjashtë dhomëshe. Një banesë shumë e bukur në stilin austro-hungarez të një pashaje apo një begu që ai ka jetu aty më parë dhe pastaj ka qenë e konfiskume nga shteti e që kështu është shitë dorë më dorë.

Edhe aty në katin e fundit ka jetue një familje ruse, më kujtohet të vjetër shumë. Ata të ikur prej Rusie të kohës së Stalinit, tepër interesant. Një qytezë, ka qenë qytezë atëherë, tash është qytet i madh. Një përvojë e jashtëzakonshme në jetë. E tash të kthehem në klasën e katërt. Pas këtij angazhimi, kur kalova në klasën e pestë pata fat po ashtu me një kujdestare klase. Pastaj isha anëtare e korit të shkollës, anëtare e grupit folklorik të shkollës dhe isha anëtare e grupit të baletit të shkollës. Edhe balet kam lujtë në atë kohë (qeshë). Baleti, për shkak, i kisha floktë shumë të gjata edhe pata lujtë zanën në një pikë që duhet t’i zgjoj nga gjumi të gjitha ato trandafila që flinin.

Këto janë ato përjetimet shumë të bukura që i barti në kujtesë edhe pse ka pasë edhe pika jo shumë të mira. Për shembull, nga pak, po kjo është injoranca e popullatës apo çfarë politika kanë qenë të kohës edhe njerëzit kanë veprue në atë mënyrë. Por, baba jem ka qenë një diplomat shumë i mirë, shumë i madh. Nana tregova, një grua shumë e kfishllë dhe baba i thoshte, “Shyqyr që s’ke krye shkollë se ishe ba ministre”. Ishte e veçantë në të vërtetë, pos asaj që këndonte bukur ishte një grua shumë e guximtare, ishte e meçme. Edhe atje normal kemi qenë menjëherë jemi ba pjesë e kishës katolike në Bosnje. Nana këndonte në kor, ishte stoliste e korit, këndonte shumë bukur. Një soprano jashtëzakonisht e bukur edhe unë këndoja në kor, këndoja në alt, alto këndoja.

Domethënë, kemi qenë shumë aktiv edhe në bashkësinë katolike edhe është shumë interesant është shoqnia e shkollës, është shoqnia e kishës, është shoqnia e rrugës, shoqnia e rrethit të dyqanit të babës. Dyqani i babës ishte afër një xhamie edhe kur ishte bajrami, “O bajrami Bajriç Nuho”, ashtu e thirrshin, ai Ndue e ka pasë emrin, Nuho, ky përgjigjeshte “*Bayram mübarek olsun*” [trq.: Me fat Bajrami]. I përgjigjeshte turqisht edhe njerëzia kurrë nuk e kanë ditë se çka kemi qenë.

Ata mendonin që jemi, na thonin që jemi kroat, jemi shiftari, jemi ksine, domethanë, tash jemi musliman, tjetër mendonin se jemi hungarez, nuk e di, qysh ju teke njerëzve mendonin për ne. Por, sidoqoftë mbiemrin e vajzëritë e kam Çetta dhe baba jem kurrë nuk e ka ndrru atë emrin edhe mbiemrin. E kemi pasë të shkruar në atë reklamën {tregon me duar} mbi dyqan e përballë i kemi pasë ni baca Ramiz. Ai Ramiz Deveri mbiemrin, po du me thanë sa interesant janë gjanat. Ka pasë shumë familje shqiptare po të cilat kanë qenë ma herët prej veriut të Shqipërisë, Lumjantë kanë qenë për shembull. Ka pasë prej Kosovës, prej Presheve, Bujanoci edhe... por, ata kishin pasë fillu të asimilohen.

Domethanë, mbiemri i ndrrum, me “iç” edhe ky baca Ramiz shkon e ndrron prej Deveri e shkrin Deveriroviç. Edhe baba përballë tash dyqanit thotë, “Ramiz zeza, t’plaçin sytë. Çka ke ba ashtu?” “Çka kam ba Nue?” Se pak belbonte. Këndonte shumë bukur përndryshe. Thotë, “Po qysh u bone viç bre burrë?” “*Aiiii* {onomatope} shuj bre se pasha Zotën pa e hjekë s’e la”. Edhe e ka hjekë edhe e ka kthye, e ka vu prapë Deveri. Po kjo ka qenë ndikimi i anëtarëve të familjes të cilët donin të bashkëjetonin në mënyrë pak ma ndryshe, të kenë ndoshta beneficione tjera, se... mbiemrat kur janë ndrrue ka pasë shumë ndryshime të mbiemrave në kohën e ish Jugosllavisë, për shkak se njerëzia kanë qenë të detyrur qofshin drejtpërdrejt, qofshin tërthorazi.

E vetmja mënyrë për t’u avancu ka qenë ajo. Ti është deshë të adaptohesh aty ku je edhe ta ndrrësh edhe gati gati identitetin tënd edhe u krye. Për fat të keq janë gjana jo të mira. Unë po shoh edhe në Amerikë kur po shkojnë, po vëjnë emra, kinezët për shembull po vëjnë emra John e ku ta di une. Po mbaje emrin tënd, së paku ajo të jetë identiteti yt. Domethënë, kjo nuk është që vetëm te ne ka ndodhë, ndodhë në krejt botën se njerëzia për me mujtë me arritë diçka në jetë janë të gatshëm të sakrifikojnë çdo gjë.

T’i kthehem bacës tem edhe Hajredin Pashës. Baba kur vinte prej dyqanit në mbarmje i lodhur, ai thoshte, “Hajde çika bacës”, e kemi pasë ni tavolinë të ultë edhe, “Hajt bacës”. Vetit ia mbushte gotën me raki, i lodhur, mua më vënte pak e thoshte, “Hajt bacës, knoja bacës kangën”. Edhe unë e këndoja Hajredin Pashën. Babës ia këndosha këto këngë, kurse nana këndonte krejtësisht kangë të tjera. Domethënë, Hajredin Pasha i takonte një lloj, shif kënga o këngë por ishin këngë të ashtu të quajtura qytetare që kishin një melos tjetër e kto ishin qoftë të çiftelisë, qoftë të llojit tjetër të këndimit.

Nëna i këndonte tjerat. Edhe falë asaj me qindra këngë i die të të gjitha trojeve shqiptare. Edhe ma vonë bashkarisht me Gjergjin, me burrin tim, ai i ka përmbledhë krejt kto kangë në një libër të veçantë por kemi pasë fat që të dytë që t’i mësojmë këto kangë edhe nga të vjetrit. Edhe është një pasuri që ka me mbetë edhe qoftë për vajzën time, qoftë për gjeneratat e juaja nëse ndonjëherë do t’ju bie

ndërmend të mblidheni e të këndonit së bashku. Ai libër është një ndihmesë shumë e madhe, sepse i ka edhe notat edhe tekstin. Të kthehem në Tuzëll?

Anita Susuri: Po, bon.

Greta Kaçinari: Tuzlla.

Anita Susuri: Ju aty keni vazhdu shkollimin deri?

Greta Kaçinari: Unë aty kam vazhdu shkollimin, aty e kam kry shkollën e lartë. Ta tregoj pjesën e, ma interesante të jetës të, domethanë... tash fillorja, në fillore kam qenë, ndoshta kam pasë fat se masi banonim jashtë qendrës, atëherë duheshte të udhëtonim me autobus deri në qendër të qytetit. Në atë kohë në Tuzëll ishin autobusat dy katësh, sepse Anglia ia pat dhurue, ia pat dhurue Tuzllës. Tuzlla ka qenë i njohur si vend ku nxirreshte kripa nga nëntoka. Është vend... prandaj edhe quheshte Tuzlla se *tuzla* në turqisht është kripë. Gjermanisht kishte me qenë Salzburg. Salzburgu i Bosnjës. Edhe është, domethënë falë strukturës së qytetit edhe rrethinës së saj ka qenë shumë interesant... domethënë ka pasë edhe dhurata nga vendet e tjera dhe mua më kujtohen këta autobusa dy katëshe.

Nganjëherë hypja naltë veç për argëtim, përndryshe rrija poshtë për të qenë e gatshme për me dalë prej tij, aty afër derës. Se aty nuk kishte derë që mbylleshin, po ishte dera gjithmonë e hapur. Dhe ai autobus ndaleshte dikund afër shkollës ku unë vijoja mësimin. Edhe më kujtohet, në atë kohë prenja është kërkue, prej klasës të pestë që të fillojmë të shkruajmë shkronja teknike. Dorëshkrimi me i dhënë rëndësi të veçantë. Edhe krejt këto i bënim me tush me fletore milimetrike.

Pastaj, në orën e BAT-it na mësonin me punue me formue këtë rrjetin elektrik {shpjegon me duar} nuk e di tash në shqip, vet me i ba kto me bateria. Pastaj si me i rregullue, në shtëpi çfarë mund të bëjmë vet dhe kto i kam, i pata mësue shumë gjëra praktike. Pastaj edhe aty, domethënë po flas për shkollën fillore prej t'pestës deri t'tetën. Mandej kur kujdestarja e klasës e shkruan në klasën e tetë këtë dëftesën e shkruan, "Ka lindur në Prizren, Republika Socialiste e Maqedonisë", une po i thom, "Jo, jo, nuk është, Prizreni nuk është në Maqedoni", ajo po më thotë, "Kuku faleminderit që më tregove se kisha me bo gabim shumë të madh". E ajo arsimtare e historisë ka qenë, kujdestare të klasës e kam pasë në të tetën.

Shumë interesant çfarë gabimi. Domethanë nuk janë marrë njerëzia shumë atëherë me gjana të cilat na sot saktësisht i dijmë kush ku është edhe saktësisht si është. Edhe çka më kujtohet nga kjo periudhë është pos atyre aktiviteteve të shumta ku kam qenë e përfshirë, më kujtohet shumë bukur që e këndonim një këngë, një këngë interesante për Podgoricën e sotshme. Ishte kangë, atje ku ishte dikur Podgorica sot quhet Titograd. Një kangë shumë e bukur. Ne e këndonim në kor atë kangë, sepse ishte kangë e bukur.

Edhe ni detaj më kujtohet nga kjo periudhë. Shkolla, krejt fatin e kam pasë që shkollat të jenë në stil, si në Prizren shkolla ka qenë "Bajram Curri" ashtu në Tuzëll. Kjo shkolla që quheshte *centar*, edhe kjo ka qenë në stilin e vjetër. Pastaj edhe gjimnazin e kam pasë në stil të vjetër. Shumë është interesant. Edhe

shkolla ishte, ishte afër edhe tregu i qytetit. Dhe një ditë para se të ndodhë zënia e diellit na tregojnë se çfarë të bëjmë. Ta marrim nga një copë xham dhe me djeg letër për me e nxi xhamin edhe ta shikojmë se si...eklip...

Anita Susuri: Eklipsin.

Greta Kaçinari: Po, me ndodhë eklipsi. Dhe ishim në shkollë. Aq ni moment i trishtueshëm kur filloi procesi dhe kur u zu krejtësisht, plotësisht atëherë, se në treg binin pula të gjalla, përpara qysh i shisnin edhe kur kanë fillue të lehin qejtë, dëgjoheshin krejt llojet e kafshëve që ishin aty në treg. Ishte shumë interesant edhe ajo ta jepte njëfarë ndjenje, krejt diqysh një ngjyrë hiri. Krejt e hirtë ishte se u ba gati pothuajse natë u ba. Edhe na e shikonim, atëherë na vendosën në dritare edhe tash shikojeni. Kjo është zënia që e kam përjetue si fëmijë, nuk më kujtohet më vonë. Ndoshta një eklips i pjesërishëm ka qenë por... kjo na ndihmonte pastaj t'i kuptojmë edhe gjanat tjera nga jeta.

Pastaj vjen gjimnazi, ku po ashtu një klasë shumë e larmishme, shumë e ndryshme. E tash më duhet të tregoj edhe diçka se baba për shkak se ishin, ishin shqiptar e këtu ndodhnin, në Kosovë ndodhnin qoftë demonstrata, qoftë, çkado që ndodhte në Kosovë kishte reperkusione tek ne në Tuzëll. UDBA e atëhershit apo si quhen këta ndryshe Ministria e Punëve të Brendshme, ata vinin në 5:00 të mëngjesit, pa lind dielli ende edhe hynin me vrull brenda në banesë tek ne dhe bënë kërkitime të ndryshme. Baba as që dinte për çka vinin e për çka kërkonin.

E para ka ndodhë, ju nuk, ndoshta nuk i dini këto por ka qenë në Split është mbajtur një, si quhen ato, Tito e ka pasë një fjalim në shqip në Split, diku '61-shi edhe atëherë ka qenë... se kta që ishin privat pat fillue privatizmi pak më tepër të zhvillohet e në atë kohë nuk lejoheshte që të ketë privatizëm të zhvilluar, po krejt të jenë shoqërore, krejt të jenë punëtorë...

Anita Susuri: Kooperativa.

Greta Kaçinari: Po, në kooperativa të ndryshme, s'ka pasë biznese individuale. Pos argjendarëve apo këpucitarëve apo qityne që janë pak ma karakteristikë. Edhe atëherë më kujtohet kur patën ardhë e patën marrë babën në pyetje. Unë e di kur kanë hy ju kom thanë, "Mirëdita, mirë se keni ardhë" atyne, ata që ishin (qeshë). Serbisht atëherë, boshnjakisht, m'falni. Se... edhe ashtu që baba im i shkreti çka do që ka ndodhë në Kosovë na ka ndodhë edhe neve në Tuzëll, deri në vitin '72 kur jom martu edhe kur kom ardhë të jetoj në Tuzëll... Prishtinë.

Interesant kjo periudha e pranimit apo mos pranimit po mirë. Ne kemi bashkëjetu atje, në shtëpi e kemi fol shqipen, qat' shqipe që e kemi bart me vete alla prizreniançe. Baba e kishte atë libezen e ushtrisë "*Nepodoban*" [srb.: I papërshtatshëm] krejt ato janë përcjellë. Ka pasë informacione që për ne kanë qenë të pakuptueshme. Vetëm më kujtohet baba thoshte, "Çika jeme, burgjet, nëpër burgje, nuk ka burgje në Jugosllavi që nuk ka me mijëra shqiptar të burgosur", unë i thosha, "Çka je ka flet? Qysh po flet kshtu?" "Po, po".

E kur doli njëri që me vite kishte qenë në burg e jetonte në Tuzëll, erdh ai të jetojë në Tuzëll, nuk e di, baba e njihte atë, i lëshuar nga burgu. Nga cili burg nuk e di saktësisht, mund të jetë nga Goli Otoku që ai është deshtë pastaj... i Gjakovës përndryshe, është deshtë të del prej Gjakovës, vendit të vet dhe ka ardhë të jetoj në Tuzëll. Edhe këto momente janë momente jo të mira. Por në gjimnaz, ashtu siç ishte...

Anita Susuri: Më falni nëse po ju ndërprejë. Para se me dalë aty, desha me ju pyetë, a ka qenë baba juju ushtar gjatë Luftës së Dytë Botërore? A ka marrë pjesë në luftë?

Greta Kaçinari: Baba im, ai ka qenë një kohë në... kur më pyete për emër, emrin e kam, i ka kalua disa muaj në Gjermani, para Luftës së Dytë Botërore si i ri. Edhe kur është kthye, a e ka pasë ndonjë Greta atje a s'e ka pasë, nuk e di. Vetëm e di se me këtë emër më kanë pagëzue dhe kam qenë me këtë emër e para në qytet. Pastaj ka qenë edhe një ma vonë, ama shumë ma vonë dhe një ka qenë në Shkup. Domethanë, në ish Jugosllavi kemi qenë tri Greta shqiptare. Tash po dëgjoj ka mjaft edhe më vje mirë. Edhe pse ndonjëherë më gabojnë më thonë Gresa, në vend "t" "s" për shkak se Greta vërtetë nuk është emër shqip. Por është emër i një artistjeje të famshme botërore edhe si fëmijë kur isha më thonin ashtu Greta Garbo.

Besa më tepër më thoshin Shirley Temple se i kam pasë floktë kaçurela edhe me një llokne kështu {tregon me duar} sepse ishin moderne në atë kohë, apo? Fëmijët të jenë ashtu të veshur me karnera, me... u ktheva prapë në fëmijëri. Pyete për babën, baba ka qenë... pastaj ka qenë në një, në një grup tjetër që ka qenë, më duket se quheshin Nacional Demokrat. Është interesant, prindërit shqiptarë për t'i rujtë fëmijët nuk iu kanë treguar shumë për jetën e tyre, për përcaktimet e tyre, për shkak se ka qenë rrezik për fëmijët, nëse fëmijët do t'dinin, atëherë do të kishin me pasë pasoja. Edhe kjo ka qenë mënyra për t'i mbrojtur fëmijët.

Ai e ka pasë ni fotografi shumë të bukur, babën e kam pasë bukurosh, edhe e ka pasë këtë kapelën, kapuçin me një shqiponje, unë nuk e di e kujt ka qenë ajo, më duket ka qenë një Lëvizje Nacional Demokrate. Edhe për atë e ka pasë të shkruar në librezë "I papërshtatshëm". Domethanë, gjenerata e tij edhe atë fotografi edhe fotografinë e Gjergj Fishtës i mbante në kuletë, në kuletën e vet. E pata pyetë, "Bacë, cila veshje është kjo?" "Eh, more bacë, me e ditë ti", "E ky kush është?" "Fishta. Eh, more bacë me ditë ti". Qe kështu kanë qenë përgjegjet e tij. Fishta më ka mbetë në kujtesë dhe për atë gjë kur kam ardhë ktu në Prishtinë ka qenë që ta gjej Fishtën (qeshë). Pastaj, kur kanë qenë demonstratat? '78-tën?

Anita Susuri: '60 kanë qenë njëherë, po mendoj, '62- '68, s'po di.

Greta Kaçinari: Epo qe kto janë këto periudha kur ate, na hynin ashtu në shtëpi e na... Kjo ka vazhdu deri në fund... edhe pas shpartallimit të Jugosllavisë ka vazhduar i njeiti avaz, se kanë kujtu se edhe vllëzërit e mi janë në rrjete të ndryshme. Për shembull, i kanë marrë për t'i pyetur a i njofin disa piktura që janë zhdukur prej dikujt, nuk e di. Kanë tentu me ma spjegu me telefon, por jo edhe shumë kjo ka qenë se rreth çkahit ka qenë ajo krejt.

Anita Susuri: A ka qenë baba juj i burgosun për arsye...?

Greta Kaçinari: Baba im nuk ka qenë... por atij tentimi të parë pas fjalimit të Titos në Split, ai ka qenë një javë ditë në paraburgim edhe atëherë e di se na kanë marrë krejt mallin. Akuza ka qenë, ju shqiptartë merrni shumë gra, ju e keni në familje ktu e në familje atje në Kosovë edhe që, po, po jetoni jetë të jashtëligjshme. Merre me mend ti këto krejt?! E nana e baba të dytë të kurorëzuar qoftë në Komunë të Prizrenit, qoftë në Kishë të Prizrenit. Bile, ato dokumente është dashtë t'i nxjerri së voni, të gjitha janë. Po, çka fliste mesi ashtu në atë mënyrë vepronin. Taman sa interesant qysh e bone pytjen edhe kjo m'u kujtue se e patën akuzu babën se i ka dy gra, një ktu e një në Kosovë.

Anita Susuri: E atëherë gjatë Luftës së Dytë Botërore a ka qenë në burg apo?

Greta Kaçinari: Jo, jo, jo. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ka qenë një pjesë në Gjermani, një pjesë në qat' Lëvizje Nacional Demokrate apo s'di, më duket se ka qenë Nacional Demokrate. E madje kta në mes vete qoftë me Ballista, qoftë me çka ka pasë lidhje apo kundërshtime, apo nuk e di saktë çka krejt. Por, ka qenë lëvizja dhe kanë qenë në mal një kohë. E di se edhe vjehrrin im na pat tregue për krejt këto lëvizje të cilat ekzistonin në atë kohë. Dhe pastaj ka qenë në marinë, e tash, të ish Jugosllavisë jo kësaj Jugosllavie në të cilën kemi jetue, por asaj mbretërore, ka qenë në marinë, aty e ka kry ushtrinë.

Anita Susuri: Ndoshta Lufta e Parë Botërore?

Greta Kaçinari: Pas Luftës së Parë Botërore, po. Nuk, domethanë nuk ka qenë, ka qenë vetëm për ta krye obligimin se ka ekzistuar obligimi ushtarak. Edhe ja kështu ai me një bagazh të vetin, na t'u përpjekë për t'u adaptue në rrethin në të cilin jetonim, të tregova për gjimnaz. Kur ndodheshin... ah, nanën e patën thirrë po ashtu një herë në biseda informative, "Çka ka predikue prifti gjatë meshës?" se tash, kjo i ka thanë "Çka ka prediku pyteni ata, ai e din ma mirë me tregue".

Pjesa e Tretë

Greta Kaçinari: Për Jamie Shea ke dëgjue? Jamie? Ai gjatë luftës ka qenë, falë asaj se çfarë ka përcjellë ai në Britani, qashtu ata kanë veprue. Përfaqësuesi i Jamie Sheas vjen këtu në shkollë te na edhe shkon me vizitue drejtorin serb. Edhe mu m'thojnë, "A ka ardhë njo i huj". Edhe unë dal i thom, "Mirëdita", po i thom unë jam filan fistekja, jam Drejtoreshë e Shkollës "Elena Gjika". Ai mbetë. Njani tha, "*Maknite se gospodo. On je završio svoj razgovor*" [Srb.: Largohuni zonjë. Ai e ka mbaruar bisedën]. Thashë, "*Nije završio dok ne razgovara i sa mnom*" [Srb.: Nuk e ka perfunduar përderisa nuk ka biseduar me mua] a din qishtu si idiot.

Anita Susuri: Cilin vit ka qenë '90 e?

Greta Kaçinari: Viteve të '90-ta dikund. Duhet me qenë '97. Me vite i kam problem puntë me i kujtue.

Anita Susuri: Përafërsisht.

Greta Kaçinari: Po, kjo ka qenë diku para luftës.

Anita Susuri: Zonja Gretë vazhdojmë ma tutje ku mbetem, ishit te nana e juj që e kanë ftu në bisedë informative dhe e kanë pytë për priftin. Pastaj çka ka ndodhë? A është kthy menjëherë nana a ma shumë e kanë pytë a?

Greta Kaçinari: Jo, menjëherë është kthy.

Anita Susuri: Si ka vazhdu pastaj? Ju keni regjistru gjimnazin?

Greta Kaçinari: Po, pastaj kam hy në gjimnaz dhe për mu fillon një etapë e re e jetës, për shkak se në klasën në të cilën kam qenë përbërja [etnike] e jashtëzakonshme. Edhe në sistemin e atëhershëm, për shkak asaj se profesorët që ligjëronin, që na jipnin mësim, vinin nga komunitete të ndryshme. Për shembull, lëndën e kimisë na ka mbajtur kroatja edhe ne deshëm e s'deshëm është dashtë patjetër të flasim kroatisht. Kroatisht në orën e saj. Ka ardhë profesori i ni lande tjetër, ka qenë boshnjak, na e kemi kthy boshnjakisht. Kur ka ardhën serbi i fizikës, na kemi folë ekafski, serbisht kemi folë. Nuk ishte e lehtë, por ishte edhe shumë dinamike edhe shumë interesant.

Dhe sot, me më pytë dikush sa gjuhë i di do të dilnin shumë se duke respektu dëshirën e tyre që ta flasin gjuhën e vet secili është interesant se ni gjuhë e cila ka shumë të përbashkëta po ka edhe dallime. Kurse në klasë, këtë më duhet ta tregoj se ka pasë edhe malazezë, për shembull e ka pasë emrin Goljub, pëllumb, edhe ne në shqip kemi pëllumba, shumë interesant. Mandej ka qenë edhe një Radojka, këta kanë qenë malazezë. Mandej ka pasë boshnjak, ka pasë serbë të Serbisë edhe serbë të Bosnjes, në të njejtën klasë. Edhe ka pasë edhe kroatë patjetër. Edhe unë e vetmja shqiptare.

Në krejt këtë, në këtë grumbull të një klase ka ekzistuar një qetësi e jashtëzakonshme, dallonim nga klasët e tjera. Ishim shumë miqësor në mes vete. Pastaj edhe programet që i kishim, për shembull në program ka qenë edhe të mësuarit e gjuhës latine, dy vjet e kemi pasë, klasën e parë edhe të dytë të gjimnazit. Unë nuk e kam mbajtur në mend gramatikën e tjera e tjera. Por ajo që kam mbajtur në mend janë të gjitha to thëniet e bukura, ato sentenca të cilat edhe atëherë gjatë shkollimit na hynin në punë, por edhe gjatë jetës ma vonë. Edhe sot e atë ditë më kujtohen shumë gjana, ashtu që...

Më kujtohet profesoresha e fizikes e cila ka qenë një, një nacionaliste serbe, për fat t'keq a... Ajo aq na ka maltretuar të gjithëve, në veçanti mua, sa që ia pata shkruar në tabelë, "Deri kur" emri i saj, "do të luash me durimin tonë?" Latinisht e kam shkruar se është "*Quousque tandem Catilina, abutere patientia nostra?*" [Deri kur do të abuzoni me durimin tonë?]. Është fjalia, një fjali me shumë domethanie. Edhe ajo është qartë pastaj por nuk e ka kuptuar kurrë se kush e ka shkruar atë. Po me rëndësi ia kemi ba me dije që nuk duhet të jetë e tillë çfarë ishte.

Ma vonë, kur kemi shkuar në Ohër në ekskurzion, unë e cila këndoja shumë ma këngët maqedone i dija më mirë se maqedonasit edhe këndoja në mbrëmje. Ajo mandej i ka ra shumë pishman edhe më tha,

“Nuk e kam ditë se je e tillë”. Prandaj, njeri s’duhet të jetë i verbum. Shovenizmi nacionalist është shumë verbues, ai verbon, helmon shpirtin, verbon sytë. Edhe njeriun e ban të keq, thjeshtë. Unë jam për nacionalizëm të ruajtjes së identitetit, por jo të urrejtjes së tjerëve. Nënë që e morën në pyetje ma tepër e kanë marrë pse është shqiptare për me kuptue çka po ndodhë, qysh një shqiptare po shkon në kishë. Se ata nuk dinin, nuk dinin se shqiptartë janë shumë universal, çka s’kanë në vete. Edhe që, domethanë, ishte edhe për ata befasi që nana ishte katolike, po shqiptare edhe që...

Ma vonë më kujtohet një profesor me të cilin pata punue edhe më thotë, “Qysh ti si shqiptare po shkon në kishë?” Unë i kam thanë, “Shqiptarë ka edhe ortodoksë”. Ai m’patë thanë, “Çka?” “Po” i kom thanë, “Ka edhe shqiptarë ortodoksë. Bile shoku i babës tem është ortodoks”. Ka qenë nifarë Spiral Llula në Prizren. Edhe ai po thotë, “Të falënderoj shumë që m’tregove se kisha me vdekë e pa ditë këtë”. Domethanë s’ka, armiku më i madh i njeriut është injoranca, mos dija se kur nuk ke informata ti mund t’lëndosh njerëz. Ai m’pat kërku shumë falje që ma pat bo atë pyetje, “Qysh ti si shqiptare po shkon në kishë?” Ishte interesant. Ma së pari për mua ishte befasi që më pyeti, shokuese ishte.

Dhe nanën e kanë lëshu menjëherë por kanë qenë shumë kundër, sistemi ka qenë kundër fretërve në Bosnje. Fretërit janë njëri prej rregulltarëve të priftërinjëve. Kanë ata disa rende të veta. Edhe që i konsideronin nacionalista, nuk e di.

Anita Susuri: Desha me u ndërlidhë ktu, e di që gjatë komunizmit feja ka qenë e ndalume, po m’duket, edhe si ka qenë për juve? A kanë shku njerëzit normal nëpër kishë e xhami apo ka qenë e ndalume?

Greta Kaçinari: Nuk ka qenë e ndalume feja. Feja nuk ka qenë e ndalume, por ata që kanë dashtë me përparue, janë, kanë, e kanë, si komunistat janë anëtarësi si komunistat e atëherë kanë mujtë me përparu. Përndryshe, populli i thjeshtë ka qenë i lirë. Unë e di, në xhami shkonin njerëzia për t’u falur, shkonin në kishë. Pastaj, qoftë në kishën ortodokse, qoftë në kishën katolike. Në kishën ortodokse shkonin ma tepër vetëm plakat edhe masi e kemi pasë mik të shtëpisë priftin e kishës ortodokse thojke, “Qysh bre te kta katoliktë krejt edhe t’ritë po shkojnë, e te une vetëm plakat po vijnë”.

Pse, se ata nuk kanë shku në kishë se kanë dashtë të tregohen se janë përparimtarë. Përparimtarë nuk shkojnë në kisha e xhamia. Edhe diçka është interesant nga kjo periudhë në Bosnje. Atje nuk ka pasë komb musliman. Në librezat edhe në letërnjoftime e kanë pasë të shkruar, “I papërcaktuar”. “*Neopredeljeni*”. Ata *neopredeljeni* që kanë dashtë me përparu, me punu qoftë në polici ose në punë të brendshme apo shtetërore, ata shkruheshin ose si kroat ose si serb. Kjo më duket tejte, tejte interesant. E pastaj Titoja, nuk e di cili vit, atëherë bashkë me Džemal Bijedić, atij ia mbaj në mend emrin vendosën që popullata *neopredeljeni* kanë të drejtë të shkruhen si musliman. Edhe ashtu ka lindë tash e një komunitet tjetër në Bosnje.

Anita Susuri: Gjatë atyre viteve a keni pasë organizime kulturore? A keni shku, për shembull në teatër apo në kinema?

Greta Kaçinari: Në Tuzëll?

Anita Susuri: Po.

Greta Kaçinari: Në teatër patjetër, vazhdimisht kemi shkue. Po ka ndodhë që një herë në vit ka ardhë edhe Opera e Sarajevës. Vinte opera, trupa operistike e Sarajevës dhe përformonin operën në teatrin e qytetit të Tuzllës. Përndryshe, kinemaja, shëtitjet e përbashkëta me klasë qoftë në natyrë, qoftë në vizita të vendeve të tjera. Mandej organizimi i kishës me vizita të ndryshme. Më kujtohet patëm shkue në Visoko, atje është, atje është bërthama, atje ka edhe shkrime shumë të vjetra edhe për shqiptarë, nuk e di a shkojnë e hulumtojnë atje. Sepse fretërit kanë shkruar për, sidomos për Shqipërinë e Veriut ku kanë shërbye si priftërinj. Ka shënime jashtëzakonisht interesante. Edhe, domethanë jemi shoqëruar shumë. Unë i kam pasë dy shoqëri, shoqërinë e klasës edhe shoqërinë e kishës.

Me shoqërinë e kishës këndonim me gitare, dilnim shëtisnim nëpër, në parkun e qytetit me shoqërinë e klasës dilsha në mbrëmje në korzo edhe atëherë ka pasë korzno në atë kohë edhe shkonim me e pi nga një kafe. Përndryshe, të gjithë ata që jam shoqëruar nuk kanë qenë të klasës së lartë edhe pse drejt me ju thanë, na kishim një jetë të një standardi pak ma ndryshe, pak ma të mirë. Po unë kurrë nuk kam dalë jashtë suazave të shoqërisë, aty, aty kam qenë. Sikur kanë qenë të gjithë edhe unë jam ba ashtu. Bile baba më thojke nganjëherë, “Qiti bre ni parë vathë të arit le ta dijnë se çika e kujt je”. Unë as atë s’e kam ba. Nuk kam dashtë se tjetër, shoktë e shoqet e mia nuk i kishin vathtë apo ndonjë zbukurim të arit. Mendoj se e mirë është kjo kështu kur nuk dallohesh në shoqëri, atëherë ajo shoqëri gjithmonë është e shëndoshë dhe shkojnë njerz të mirë mes vete.

Jeta personale e individuale duhet t’jetë jashtë asaj se... ka ndodhë një herë se kam dashur pas operës t’i qerasë krejt shoqërinë e kishës e atëherë unë e dua shumë Shën Ndoun, Shën Antonin edhe atij iu kom lutë shumë si vajzë e re. Bile, bile falë atij kanë ndodhur disa kthime të mëdha në jetën time edhe i them, “Kqyre”, domethanë unë me Shën Antonin po flas edhe po i them, “Kqyre krejt çka të mbetë prej qityne pareve që kena pi kafe krejt ty ka me t’i dhanë”. Edhe dolëm na, u kry opera. Dolëm prej operës. Hajde po shkojmë me pi nga një kafe, krejt të mbyllme, askund asnjë kafe e çelme. Ishte ora 10:00 edhe krejt të mbyllme edhe thashë, “O hajde bre se krejt duhet me ia dhanë Antonit”, “Cilit Anton?” Po thom, “Shën Antonit” (qeshë). Edhe ashtu që krejt ata çka është deshtë për kafe une i kam thanë, “E qe, t’i pruna ty”.

Por, kur e kam pytë Shën Antonin edhe i kam thanë, “Kqyre, ti më ndihmo qysh t’dush ti”, kur ka qenë një njoftim i parë, “Nëse ti mendon se është në rregull le t’bahet, nëse nuk mendon prishe”. E prishi të parin, të dytin. Po i them, “Kqyre”, prapë njësoj, “nëse ti mendon se nuk është për mua prishe”, u prish. Kur rasti i tretë i kam thanë, “Kqyre, Shën Anton, deri qetash i prishe krejt. Kësaj radhe do t’vendosi vet”. Edhe vet kam vendosë edhe më ka dalë shumë ma mirë se me ato dy rastet tjera. Absolutisht. Ma vonë jeta i tregoi të vetat. Por më ka përkrah në rastin e tretë patjetër. Kam pasë një besim të fortë në, edhe sot e atë ditë njësoj.

Anita Susuri: Rasti i tretë ka qenë bashkëshorti i juj apo?

Greta Kaçinari: I treti.

Anita Susuri: Si jeni njoftu? A po na tregon?

Greta Kaçinari: A ta kryj gjimnazin?

Anita Susuri: Në rregull.

Greta Kaçinari: Mirë. Pasi e kreu gjimnazin... nga gjimnazi kam shumë kujtime të bukura, për shembull, vrapimi i shtafetës në atë kohë edhe nuk kam mund të shkoj të bartë shtafetën ai nxanës i cili ka pasë notë t'dobtë. Qashtu që unë kam qenë në grupin që kanë shku edhe ky ishte gëzimi i madh. Nuk ishte, gjimnazi nuk ishte aspak i lehtë, ishte një ndër shkollat më të vështira në qytet. Tjerat ishin shkollat profesionale, ekonomike, teknike, ku ta di une, por kisha fat që isha në gjimnaz. Edhe pse e kam dashtë shumë edhe muzikën, por për muzikë nuk m'u ka ba asgja, as që të mund të regjistrohem se kanë mujtë të dyjat paraleleshit të shkojnë. Por, nga një moshë e caktuar unë jam vonu për atë. Po muzika s'më ka mungue në jetë për shkak, se mandej bashkëshortin e kam pasë muzicent.

Domethanë m'u kanë plotësuar shumë dëshira në mënyra të ndryshme, interesante. Më kujtohet edhe diçka që gjatë kësaj periudhe ne vinim çdo vjet në Prizren. Ma vonë gjyshja kur ka kalu me dajën në Prishtinë, vinim në Prishtinë. Por, në Prizren kam pasë rast, kështu, të shkoj një herë në këmbë në Zym prej Prizreni. Jemi çue dikund në 03:00 në mëngjes për me shku krejt shoqnia, krejt të rinjtë, shumë bukur ka qenë jeta në Prizren.

Edhe këtu më pyet njëni që ishte vet profesor i historisë, i njoftun, ka jetue ma vonë në Zagreb, Zef Mirëdita, nuk e di. Ai po m'thotë, "Ti çika e mirë", kështu ai {tregon me duar} e ka pasë në qëndrim t'veçantë, i gjatë ka qenë edhe i pashëm. "Ti çika e mirë po e kryen gjimnazin a?" Po i them une, "Po", "Çka don me studiue?" "Drejtësinë", ai tha, "Ti po don drejtësinë me studiue?" Unë po i them, "Po, më pelqen shumë", ai tha, "Mendo shumë e shumë për ta regjistruar drejtësinë. Në drejtësi nuk duhet të shkoj çdokush".

Merre me mend ti. Po s'ma ka thanë këtë por s'ia kom mbushë synin se unë isha e shkurtë, për me studiu drejtësinë duhet t'isha e gjatë si ai (qeshë). Edhe... por edhe kjo e drejtësisë ma vonë në jetë më është plotësuar në mënyra të ndryshme, shumë interesant. Ende sot e atë ditë i shfletoj ligje të ndryshme për ta kuptu punën që e bëj. Kjo s'ka t'bëjë vetëm me ligje, ajo është thjeshtë një ushqim shpirtëror, kulturor që njeriu t'i dijë këto gjana.

Kur e kreu gjimnazin atëherë nga lëndët e doja shumë, t'gjitha lëndët shoqërore i doja. Edhe lexoja shumë, sidomos kemi pasë sociologji edhe filozofi, këto dyja, gjuhën latine e doja shumë edhe gjuhën gjermane. Edhe ma vonë ëndërroja të studioj gjuhën gjermane. Shumë ëndërroja kom pasë. Drejtësia, ta studioj gjuhën gjermane, ta studioj psikologjinë e fëmijëve se i doja shumë fëmijët. E thoja kur të marrohem unë do t'i kem dhjetë fëmijë. Mirë. Sa i përket kësaj pata ra në pesë pastaj, domethanë në një ekip basketbolist. I pari ishte ekip futbollist, i dyti basketbolist, por rash në një se ashtu ishte vullneti i Zotit që i kompenzoi krejt këta edhe jo vetëm krejt këta, por pastaj unë kisha me mijëra fëmijë në jetën time ma vonë në profesionin tim.

Edhe, u krye gjimnazi fillova të studioj gjuhën angleze, doja gjermanishten, nuk kishte gjermanisht kishte anglisht edhe fillon një etapë e re e jetës sime. Pasi që e kam krye isha e interesime të punoj, nuk e thashë këtë se më parë kur i pata thanë, pas kryerjes së gjimnazit, i pata thanë babës tim, “Unë dua të shkoj të studioj në Zagreb psikologjinë e fëmijëve”, ai m’tha, “Jo bre, çika jeme, rri ktu. Qe munesh edhe mua me më ndihmu në dyqan”, “E ki totën boll, ajo po të ndihmon”, “Po, mirë është ti me ndejt ktu”, a din.

Edhe unë e dëgjoj edhe nuk shkoj në Zagreb. Ta dini se kam pasë mundësi të shkoj. Nuk ia prishi qejfin edhe rri edhe tash po mendoj po mos të kisha dëgjue edhe të shkoj atje, jeta ime do të merrte krejt kahje tjetër. Sa mirë është me dëgju prindin nganjëherë. Jo nganjëherë, në jetë duhet ta dëgjosh prindin. Po e lidhi me atë të parën, “I lumi ai që e dëgjon prindin. Dëgjo prindin ndaq me jetue shumë përmbi dhe”.

Edhe e regjistroj anglishten, kam studiue mirë e kreu edhe tash po du me u punësue. Shkova provova në një shkollë fillore, krejt kjo po flas për Tuzëll. Provova me shku me një shkollë fillore, “Jo”, tha, “na e kemi të zënë vendin”. Kur një ditë troket dikush në derë, kojshia përballë që kishim m’thotë, “A po vjen me punue te ne?” Ishte shkollë e mesme, shkollë e mesme profesionale e xehtarisë. “A po vjen se po na duhet një profesor i gjuhës angleze?” Edhe unë i them, “Hajt”, po shkoj. Edhe vërtetë kam punue. Kam punue pothuajse dy vjet atje derisa nuk u martova.

E tash te ajo pyetja e yte, si jam njoftu me Gjergjin. Meqë ne vinim shumë shpesh në Kosovë edhe vitin 1972 erdhëm për festën e Zojës së Madhe në Letnicë. Por vinim ma herët, nga një javë, një javë ma herët kemi ardhë. Edhe aty unë e shoh një djalosh, i pashëm, pak floktë e gjata, një xhamper të lidhur. *Hmmm* {onomatope} Ditën u zhduke, në mbrëmje vinte. Edhe kush është ky, e kush është ky, ne jse e morëm vesh se kush është. Edhe ashtu masi unë këndoja bukur, dua të them edhe diçka, se prej vitit diku ‘64- ‘65 na çdo vjet kemi ardhë në Letnicë, ka ni javë ka dy javë përpara.

Në një fshat i cili s’kishte ujë, i cili s’kishte rrymë. Banonim nëpër ato shtëpiza të fshatarëve të tyre, flenim në dyshek të mbushura me kashtë e me sanë, me sanë të mbushura, me sanë. Por ato janë kujtimet më të ndritshme të jetës time. Mblidheshte rinia nga të gjitha këto familje që në fillim i tregova që diku viteve ‘50-ta që janë shpërngulë. Dhe aty njoftoheshin të rinjtë në mes veti edhe shumë martesat ma vonë kanë ndodhur falë këtyre takimeve.

Anita Susuri: Desha me iu pytë, në Letnicë a keni fletë nëpër shtëpia private apo jashtë në *predgrade*² që i kanë thanë ata?

Greta Kaçinari: Jo nëpër shpija private. Në *predgrade* kanë fjetë vetëm kroatët. Ata e kanë pasë atë si të ozurpune, prandaj shqiptartë flinin nëpër shtëpia private, nëpër ato shtëpiza të marume me lloç. Pastaj tepër tepër interesant ka qenë. Problemi ma i madhi ka qenë uji normal. Edhe uji i cili rridhte, shumë i rrezikshëm për t’u pirë për shkak të mungesës së jodit. Vendasit kanë pasë probleme me gushë se uji natyreshëm por pa jod.

² Hapësirë për banim në ambient të jashtëm gjatë qëndrimit në Letnicë.

Edhe kështu që Gjergji e unë njoftohemi dhe që thojnë ishte shikim, ishte dashni në shikim të parë. Të njejtin [vit], na jemi njoftue në gusht, në shtator jemi fejue, në nëntor jemi kurorëzue, jemi martue. Unë kam ardhë prej Prizreni, kurorëzimin në komunë e kemi ba këtu edhe shumë me mend sepse ishte deshtë ta nxjerri, të shkoj në Tuzëll. Kurse kurorëzimin në kishë e kemi ba në Tuzëll edhe dasmën e kemi ba atje. Me çallgixhitë e Prizrenit, e dini çka janë çallgixhitë? Po?

Anita Susuri: Po, muzikantët. E si kanë ardhë ata në Tuzëll?

Greta Kaçinari: Me ekipin muzikor të Prizrenit. Ishin ata të shoqnisë “Agimi” edhe ashtu që u ba një dasmë e mirë dhe ne, hyra në ujëra të tjera të jetës. Një javë ditë i kemi kalu në Rovinj, e kemi qarosë vetën, atje kemi shku si bashkëshortë të ri. Këtu në fillim kur kam ardhë në Prishtinë, si, ditët e para të martesës, lugu e para të mjaltës, edhe një javë ditë kemi fjetë në Hotelin Bozhur. Gjergji nuk kishte banesë këtu, ai udhëtonte prej Prizrenit, punonte në Radio Prishtinën e atëhershme. E pastaj miqtë tanë, të afërmit tanë na gjetën një banesë private që të mos të udhëtojmë tash ne prej Prizrenit që të dytë, ashtu që filluam një jetë krejtësisht të re.

Në Prishtinë pastaj dolën shumë njerëz të cilët tashmë kishin ardhur edhe prej Prizreni edhe prej vendeve tjera, ashtu që fillim të shoqërohem në mes vete. Dhe ky shoqërim ka zgjatur deri në fund të viteve ‘80-ta. Edhe pastaj shoqërimi ka vazhdu në mënyra të ndryshme, ashtu siç po bahet edhe sot përmes telefonit, përmes ktyre mjeteve të reja të komunikimit. Por është një periudhë shumë e bukur e jetës. Në shoqëri e kemi pasë Simon Shirokën me familjen e tij, ata i kam edhe të afërm. Pastaj të kumarës tonë të kurorëzimit Umbertoja, tash në Çeki. Marcelto Peci që ishte lojtar, valltar i “Shotës”, me të vallzonim vazhdimisht, Lezja, dhe plot të tjerë.

Një familje, mos, nga krejt kjo mos ta harroj edhe bacën Anton Çetta, të cilin më thoshte, “Mos t’vjen marre me thanë se je e jemja” se unë me vajzni Çetta. “Jo bre baca Anton po kërkush nuk po më pytë mbiemrin e vajzërisë, unë tash e kam ndrrue”. Pastaj të dajës të Mark Kaçinarit kompozitor. Domethanë, jeta ime ka kalue e ndarë, përmes muzikës dhe profesionit tim në arsim. Unë pastaj këtu kam vazhdu... edhe këtu ka qenë interesant. Si në Tuzëll që më ka trokitë në derë komshia për me m’thanë që kanë nevojë për një mësimdhënës të gjuhës angleze, kështu ka ndodhë në Prishtinë.

Biri i komshikës, familje serbe ka qenë, thotë, “Teta Greta, po na mungon bre arsimtari i anglishtes”, une po i them, “Po thuaju atyne atje te shkolla se një mësuese po rrin në shtëpi”. Edhe djali ka shku i ka thanë kujdestarës së vet edhe kujdestarja i ka thanë, “Po le t’vjen ajo vet me shikue ku është puna”. Unë tashma vajzën e kisha diku, sa ishte ajo atëherë, ‘73, ‘79, diku pesë vjeçare edhe... pastaj Radio ia ndau Gjergjit një banesë edhe banonim tek Kaçallarët. Janë aty dy ndërtesa të bardha tash ato janë ma t’shkurtat tjerat janë rritë që janë ndërtu të reja. Po prej dritares sime shiheshte shkolla atëherë “Vuk Karadzić”.

“More”, une thojsha, “Sa mirë me qenë të punoj këtu”, shkolla afër banesës edhe Florindën do ta mbikqyri edhe krejt kish me qenë okej. Edhe ky djali kshtu thotë. Edhe unë vërtetë shkoj në shkollë edhe kur hy brenda filloj të flas serbisht se t’u kujtue se hala jam në Tuzëll. Befasi ka qenë për mua kur

i dëgjoshja t'u folë shqip të tjerët. Edhe prezantohem, kur ai sekretari fillon me dikë flet shqip, unë ia kthej shqip, tha, "A shqiptare je a?" "Shqiptare jam". Edhe kështu pranohem aty. Fillimisht kam punu në paralelet serbe, fëmitë më pyesnin prej kahit jam, kush jam, ata mes vete pastaj, "Jo kjo ka ardhë prej Anglie", "Jo", tjetrit thonë, "kjo është prej Kroacie", "Jo, jo, është hungareze".

Secili mendimin e vet edhe unë kurrë as nuk kam ndërhy as nuk kam pasë nevojë t'ju them, të hy në ato problematika. Edhe gjatë këtij viti drejtori i shkollës e sheh se dy vajzat i ka pasë në klasë në gjuhën serbe. Drejtori i shkollës ishte serb edhe ai më thërret vitin tjetër edhe thotë, "Këtë vit keni me punu, keni me dhanë edhe shqip në paralelet serbe, në klastë e katërta", unë po i them, "Jo, nuk mundem. Unë gjuhën shqipe e flas alla prizreniançe. Unë nuk e njoh gjuhën e re", se tashmë kishte hye në përdorim gjuha e, gjuha shqipe letrare. Unë vërtetë nuk e njihja, edhe pse falë babës gjuhën shqipe vetë e kam mësue në Tuzëll, falë revistave, revistës "Jeta e Re".

Ai e merrte, na vinte rregullisht edhe unë i kam dëshifru shkronjat t'u i krahasu me alfabetin serbo-kroat edhe i kam gjetë dallimet ku janë, e kam ditë si shqiptohen se ato fjalë tu i përdorë. Domethanë, vetë e kam mësue, i kam mësue fillet e gjuhës shqipe. Kur më tha ky kështu, "Jo", tha, "S'po t'pys a din me folë a jo. S'po të pys". Edhe, çka t'boj? Tre fjalor para vetës, librin e anglishtes përktheje shqip. Se librat për klasën e pestë të anglishtes kanë qenë shumë të mirë, ka pasë shumë vjersha, mnyra e komunikimit edhe unë ato krejt e bojsha planin tim. Dhe fillova vetë ta studioj dhe ta mësoj gjuhën shqipe, ma vonë edhe vajza filloi në klasën e parë.

Fillova krejt t'u e mësu gjuhën shqipe, t'u lexue, sidomos t'u dëgju radion, t'u lexu gazetatat, revistat saqë njëri më pat thënë, "Më fal, mos je ti nga Dibra?" Aq ka avancu gjuha ime alla prizreniançe. Por ma vonë, ma vonë filloi të, u fut në përdorim gjuha angleze edhe në paralelet shqipe erdh ni drejtor shqiptar. Më transferuan në paralelet shqipe. Atëherë filloi një periudhë krejt e re, tash me nxënës shqiptarë. Me ta, atyne ju thosha, "Nëse doni t'ju mësoj gjuhën angleze ju të më korrigjoni, kur flas shqip të më korrigjoni". Edhe ashtu e kemi pasë ni marrëveshje të ndërsjelltë, unë i mësojsha ata anglisht, ata mua shqip dhe mirë shkonin punët.

Kur kam ardhë këtu, baba më ka thanë një fjali, "Çika jeme, kur shkojsh atje mos ndrysho". Çka kam une me ndryshue? Kur erdha këtu vërtetë pashë se... ose të bëhem si të tjerët ose të mbes ajo cila jam e që ishte bukur vështirë. Isha shumë e lirë, e lirë në biseda me të tjerët, në komunikim me të tjerët. Për mua s'kishte dallim, a ishte kolegu a kolegja, hiç kurrfarë dallimi. Por komunikime nuk kishte shumë ndërmjet gjinisë femërore dhe mashkullore. Kjo ishte e tmerrshme, singërisht. Edhe më kujtohet një natë në korzo me burrin tim me Gjergjin t'u shëtitë po kalon një koleg i imi edhe unë po them, "Gjergj kqyre" filan fisteku mos t'ja përmendi emrin se gjallë është ende. Po i them, "Kqyre", ai e kthen kokën edhe unë mbes e befasume. As nuk mberrina me përshëndetë, ai mu jo se jo.

Edhe të nesërmen, "Pse ti e kthen kokën në rrugë?" "Po kumeditë unë çfarë burri ke ti", "Burrë kam boll t'mirë po ti mendo për vetëvete", singërisht. Tmerr a! Zot faleminderit që këto nuk ka ma kështu. Dhashtë Zoti e mos të ketë, se këto janë gjana që ia lidhin njeriut shpirtin bre të sakatosin, e kufizojnë krejtësisht. Edhe ja kshtu. Kemi fillu me u përshëndet më pas (qeshë). I ngucsha shumë.

Anita Susuri: A keni dalë shpesh nëpër korzo?

Greta Kaçinari: Vazhdimisht, vazhdimisht.

Anita Susuri: Qysh ka qenë jeta shoqërore atëherë? A keni dalë me shoqëri?

Greta Kaçinari: Ktu në Prishtinë?

Anita Susuri: Po.

Greta Kaçinari: Në Prishtinë, jo që dilnim në korzo po u takojshim qikjo shoqëria që ishim ma shumë se 20 veta. Merreni me mend në banesën në dhomëshe 23 veta të ulur rreth tavolinës e t'u këndu tanë natën edhe kurrë në këngë mos me u përsëritën. Krejt të lidhura. Normal që pastaj lind libri i këngëve të vjetra popullore, shumë të bukura. Edhe këndonim të gjithë. Është interesant shqiptartë në përgjithësi kanë vesh vet për... kanë talent për të kënduar.

Edhe normal ktu edhe kisha e ka lujtë rolin e vet me kore, qoftë prej fëmijënisë, mandej koret e të rriturve, mandej kombinimet. Mirë ato janë këngë kishtarë, por kur të zhvillohet veshi e zani gjatë këndimit, ai atëherë shfrytëzohet edhe për këngë tjera të jetës. Kënga është pjesa ma e bukur e jetës sime, sepse këngët shqiptare janë shumë të veçanta dhe kanë, po flas, për këngë të mirëfillta, për shkak se përmbajtjet tekstuale të tyre kanë edhe kuptim edhe kanë, janë përçues i ndjenjave.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: M'tregutë pak për jetën, shoqërinë që e keni pasë për daljet, si ka qenë Prishtina në atë kohë? Kur keni qenë e re? Kur keni fillu me punu?

Greta Kaçinari: Prishtina e kohës kur kam ardhë në '72-shën të jetoj këtu, nuk ka qenë kumeditë se sa qytet i zhvillum. Ky vendi ku unë banoj ka qenë një vend shumë i largët nga qendra, në të vërtetë s'ka ekzistuar fare. Domethanë, ka ekzistuar vetëm qendra edhe pjesa e vjetër e qytetit, e cila deri më sot ka psue shumë ndryshime. Pastaj kanë filluar këto ndërtesat. Ndërtimi i pjesëve të tjera të qytetit. Bile, më kujtohet sahere shkonim në Prizren dhe kur ktheheshim në, prej Veternikut e te poshtë, thosha, "He more Zot, aman, a thu do t'ndërtohet ndonjëherë ndonjë shtëpi këtu në anën e majtë". Domethanë, tash ku është Lagja Kalabria ose në anën e djathtë. Ishin djerrina ishin, domethanë '72-shën.

Për sa vjet po i bjen? Gati për 50 vjet është ba krejt ky ndryshim. Unë e shoh si gjë pozitive krejt këto çfarë kanë ndodhur deri në ditën e sotshme, sidomos ndryshimi i pamjes së qytetit. Tash mund të krahasohemi edhe me qytetet botërore, qytetet e qytetërume. Na duhet edhe pak të, ta ngrisim vetëdijen e njerëzve për mirëmbajtje dhe hapësirën në të cilën jetojmë por unë jam e lumtur që arrita që në këtë moshë të shoh që edhe në anën e majtë të Veternikut që edhe në anën e djathtë të

Veternikut që të ketë vendbanime, që të ketë shtëpia, ndërtesa, të gjitha ato që e bajnë jetën e njeriut më të mirë.

Isha te '72-shi kur fillova me punue pastaj, jo '72-shën jam martu. '79-shën kam fillu të punoj, falë atij fëmiu që m'ka thanë që nuk kemi arsimtare të anglishtes dhe falë drejtorit i cili ishte atëherë që fillova të jap edhe gjuhën shqipe në paralelet serbe. Ishte një periudhë shumë dinamike e jetës time. Atëherë iu futa thjeshtë studimit të gjuhës shqipe që ma vonë e kam pa si dhuratë në jetë. Jo vetëm pse është gjuhë e ime amëtare se ajo gjuhë amëtare e konsiderojmë gjuhë amëtare edhe hajt. Por kur ti futesh në literaturën e gjuhës amëtare atëherë gjuha edhe pasurohet edhe falë kësaj ma vonë kom pasë ngjarje të ndryshme në jetë kur edhe kjo më ka ndihmuar shumë.

Kur '81-shën ishin demonstratat në Prishtinë, unë atëherë vazhdova të punoj dhe i shifsha në kolektiv që punët nuk janë si duhet, arsimtarët serbë ishin shumë të shqetësime edhe e di se jam përpjekë t'i qetësoj, t'i marrë me t'mirë. Nuk e di edhe unë nuk e dija vet se çfarë po ndodhë. Kishim pak informata, por jo edhe shumë. Atëherë filluam të dëgjojmë edhe televizionin e Tiranës, Shqipërisë nganjëherë e kapshim ashtu edhe e pamë se diçka po lëvizë, diçka nuk është në rregull. Më kujtohet, ishin, ishte ora policore edhe e kisha një fëmijë shqiptar, familja e të cilit jetonte në Graçanicë. Edhe ai fëmijë pat mbetë, s'ka ardhë askush me e marrë edhe pat mbetë në shkollë, e kam marrë në shtëpi.

Anita Susuri: Ditën e protestave apo?

Greta Kaçinari: Gjatë orës policore. Edhe fëmiun e mora në shtëpi dhe më kujtohet, çka me ba? Qysh me lajmëru prindërit që fëmija është shnosh e mirë? Edhe unë e thras policinë edhe ju them, kështu kështu kështu, jam kjo e kam një fëmijë ktu, ata fillun me qeshë. Më besoni. Kurrë s'e harroj këtë. Edhe ju kam thanë, "Kjo nuk është për të qeshur por iu kisha lutë që prindërit e këtij fëmiu t'i lajmëroni se fëmija gjendet tek filan fisteku". Edhe, "Si urdhëroni zonjë, ashtu do të bëjmë", me sarkazëm. Por, sidoqoftë e kanë lajmëruë familjen. Edhe të nesërmen atëherë vëllau i madh i këtij çuni erdh për ta marrë djalin. Tash këta jetojnë diku jashtë Kosove, diku jashtë, në Gjermani a dika. Por më kujtohet kjo, ishte e trishtueshme.

Mandej përcjellja e fëmijëve, për besë, kjo ka ndodhë ma vonë. Gjithmonë diçka më ka përcjellë kështu me u kujdesë në mënyrë të veçantë për fëmijët. Ka ndodhë viteve të '90-ta që kemi ndejtë deri në ora 10:00 në shkollë t'u pritë që t'vjen dikush t'i merr fëmijët, në ora 10:00 të mbrëmjes. Sidomos atje, në ato pjesë ku duheshin fëmijët të shkonin, e prindërit nuk mundeshin apo dikush i afërm i tyre me ardhë me i marrë fëmijët. Ashtu që, por pjesa më e bukur e jetës sime kanë qenë vitet e '80-ta, do të thotë, shoqëria, jeta publike, "Akordet e Kosovës", teatroja, rrallë në kinema e që shumë shpesh sa isha vajzë e re vazhdimisht shkoja. Edhe... falë krejt kësaj edhe e kam kriju një botë në mendjen time, një botë të veçantë, një botë që mund të jetë shumë ma e bukur sesa është.

Edhe t'i kthehem viteve të '80-ta kur takoheshim, kur këndonim edhe kur e çonim një jetë të bukur shoqërore. Pastaj takimet edhe takimet e tjera si, takime letrare, takime, krejt këto kanë qenë pjesë e jetës sime në atë periudhë edhe ma vonë. Ashtu që, kam pasë fatin të njoh shumë njerëz krijues, qoftë në fushën e muzikës, qoftë në fushën letrare, qoftë në fushën e artit. Ashtu që, ajo sot është ushqimi i

shpirtit tim. Jo që kthehem mbrapa me kohë, por thjeshtë ka mbetë ushqim i cili ende më mban. Ajo çka është ma e bukura është puna me fëmijët, që ka qenë pjesa më e madhe e jetës sime profesionale. Puna e drejtpërdrejt me ta, domethanë si mësimdhanëse.

Ka pasur raste kur unë i shijsha kolegët e tjerë i jepshin edhe nota të pamjaftueshme, njësha, dysha. Kishte edhe te une nxënës që nuk dinin. Edhe një grup prej tyre diku pesë-gjashtë veta ishin që prej të gjitha klasave u mblodhën, klasa e shtatë, edhe kjo është një përjetim shumë i veçantë. Mësimi vazhdues edhe provimi në gusht. Gjatë atij mësimi të vazhdueshëm, unë i mora disa tema që kishin të bënin edhe me jetën sociale edhe po i pyes, “Sa para të jep prindi për para xhepi, për *džeparac*, për *pocket money*?” Edhe ai njani thotë, “Valla me t’thanë drejtë mu baba jem s’më jep kurrë kurgja. Po une shkoj me karrocë në treg i barti sendet për dikë edhe ata m’i japin qato pare. Unë mandej ato pare ia jap babës tem”.

Ky kështu, tjetri mandej ma tregoi jetën e vet. Kjo tash u harro anglishtja. Tjetri ma tregoi të vetën, qysh ai ka andërr me u ba boksier, por ai nuk mundet se ai duhet ta ndihmoj babën me pula e me ku ta di unë. Edhe kthehem në klasë, kthehem në sallën e arsimtarëve edhe ta hedhi ditarin shumë e emocionune edhe them, “Prej sotit Greta kurrë asnjë fëmie ma nuk ka me i dhanë njish, kurrë! Ajo notë për mu nuk ekziston”. Edhe kurrë në jetë nuk kam dhanë njësh, nuk kam dhanë as dysh bile. Dyshi më dukeshte shumë nënçmues. Njëshi është për panjohuri, *it’s okay* [Eng.: në rregull], por të jap une i cili e mban familjen të jap njësh nga gjuha angleze, që në atë kohë njohja e gjuhës angleze ishte luks apo...

Ishte e palogjikshme për mua. Ashtu që, ajo mandej më kfjelli pak dhe kam fillu të mendoj mirë e mirë për secilin veç e veç. Ka pasë raste kur fëmija në klasë të pestë pesë, gjashta pesë, në të shtatën ra. “Hajde ti ktu”, ka fundi i vitit tash duhet me u mbyllë notat, “Kqyrë, sa e ke pasë në të pestën? Pesë. Në të gjashtën? Pesë. Në të shtatën po ta fali pesin, për hirë të pestës e të gjashtës. Por prej teje pres në të tetën. Krejt çka ka ndodhë këtu me kompenzue”. Më besoni në të tetën, jo vetëm e shtata por edhe e teta ka shkue për mrekulli.

Anita Susuri: Desha me iu pytë për vitet e ‘80-ta po flisnim edhe u afruam ‘81-shit. Më tregutë për orën policore por kur e keni vrejtë që po bohet situata ma e keqe edhe që po ofrohet marsi, domethanë, studentat kur janë çu në protestë. A u vrejtë kjo?

Greta Kaçinari: Tash ‘81-tën demonstratat e studentëve...

Anita Susuri: Po.

Greta Kaçinari: Patjetër se është vrejtë sepse, me atë që unë kojshitë i kisha serbë, kisha paksa informata edhe nga ana e tyne çka po ndodhë, jo çka po ndodhë po frikat e tyre. Edhe pse ata as që kishin nevojë të frikësoheshin, isha dashtë unë të frikësohem e që unë nuk u frikësoja se në atë kohë, meqë lëvizja ishte e kufizume edhe nuk kishe mundësi me dalë edhe meqë punonim. Në ato ditë që është ndërpre mësimi, më kujtohet kojshika, motra e kojshikës që ishte pak ma e re, edhe ma e re se une, edhe na dyja dilshim në dritare. Në atë moment po kalojnë disa të veshur ushtarë me armatim edhe po kalonin edhe po na bon kështu {shpjegon me duar} hyni brenda.

Merreni me mend, as në dritare s'kemi guxu me dalë. Edhe po na bojnë kshtu {shpjegon me duar} edhe unë po i them kësaj, "A të hyjmë brenda? Se po mbesim si Bora e Ramizi" (qesh). Po ni skenë jashtëzakonisht e padëshirueshme, jo e mirë edhe e frikshme besa. Por, disi kaloi edhe ajo periudhë, po meqë... ma vonë kam pasë rast ta kem një arsimitare në shkollë, e cila ka qenë pjesëmarrëse e demonstratave, ka qenë e plagosun. Dhe... dhe se ajo më rrefente pastaj se si i kanë përjetue krejt këto. Ka qenë, kanë qenë fillet e asaj çka sot ne po gëzojmë. Mos të kishin qenë ato edhe ato të ma hershmet, po edhe ato që kanë pasue pastaj të studentëve, të '91-shës, '92-shës, janë, janë lëvizje të cilat është deshtë të ndodhin.

Për shkak krejt asaj se çka përjetonte ky vend. Krejtësisht pa nevojë, apo? Kanë mund të kenë një, domethënë, pas '74-shës ka mund të ndodhë diçka ma ndryshe, nuk ka ndodhë apo? Por ka mund të ndodhë bash *peacefully divorce*, ndarje paqësore e jo të vijë të ketë kaq dhimbje, kaq gjak e kaq dhimbje të shkaktuar jo vetëm tek ne në Kosovë po edhe në Kroaci edhe në Bosnje edhe gjithkund. Edhe në Mal të Zi besa, edhe në Maqedoni, krejt Jugosllavia është e përgjakur, qoftë prej durve që i kanë përgjakur duart, qoftë prej atyne që kanë rrah e kanë humbë jetë.

Anita Susuri: A jeni bo ju pas viteve '81 drejtoreshë, a kur jeni bo?

Greta Kaçinari: Jo, jo. Unë jam bo zëvendës drejtoreshë në '89-ten, para viteve të '90-ta domethanë, n'fund. Kjo krejt periudha e viteve të '80-ta, unë kam qenë mësmdhënëse. Edhe, edhe janë edhe përjetime të bukura të asaj periudhe qoftë shoqërorizimi, qoftë... sidomos më pëlqente kur vinte Shën Gjergji, po e them me qëllim Shën Gjergj, sepse atëherë bashkësia e romëve apo ashkalive apo kushdo që ka jetu në atë pjesë të lagjës ku banoja atëherë, ishte festë kur ata e festonin me 6 maj apo 7 maj, me sa bie?

Anita Susuri: 5.

Greta Kaçinari: Me 6 maj, po. Edhe atëherë me kangë e të veshur bukur e me vallëzime shkonin për ta festue në një vend tjetër. Kjo është pjesa e asaj lagjës ku edhe si thashë është te parku i vjetër, pjesa e vjetër e qytetit. Mandej përparësia e asaj banesës ni dhomëshe ku kemi banu është se ishim në katin e pestë. Dhe ni detaj paksa i frikshëm për mua në atë kohë ishte kur vajza ime, të cilën e lija vetëm në shtëpi, nuk ia mbyllsha derën, se në atë kohë s'ka pasë hajni, nuk e mbyllsha derën ashtu që nëse vajza don me dalë, që të del. Për çfardo rasti. Nuk ka qenë e kyçne dera e hyrjes së banesës. Po e shoh vajzën prej dritarës së shkollës po e shoh dritaren time vajza në dritare. Jam tmerrue kur e kam pa. Në katin e pestë.

Edhe shkoj në telefon edhe e thras edhe i them, "A ishte parëz në dritare?" Thotë, "Po", "T'lutem mamit mbylle dritaren edhe mos dil ma në dritare". "Ku po m'sheh ti?" "Ehhh, une t'shoh çdo kund edhe nga çdo cep se çfarë bën ti". Edhe ashtu që ky ishte momenti i trishtueshëm për mua. Por, ja që Zoti deshi që ai fëmijë të më troket në derë dhe filloi të punoj në atë shkollë. Aty pastaj ka fundi i viteve '90-ta, '80-ta pardon, atëherë filluan trazirat e llojit tjetër edhe në marrëveshje me kolegët e shkollës edhe me dy kolege tham të trijat po konkurojmë për zëvendës drejtor. Por, ato po thonë na do të tërhiqemi, e

unë po them, “E çka me u bo une zëvendës drejtor? Ku di une me u bo zëvendës drejtor?” “Qishtu po ia bojmë, qishtu na duhet”.

Edhe këto ishin etapat e para të vetëdijësimit tonë që të mirremi vesh në mes vete nëse dëshiron diçka të arrijmë. Dhe atëherë u bëra zëvendës drejtor. E atëherë e prunën drejtorën e dhunshëm, sikurse ndodhi në të gjitha shkollat. Me atë që në shkollën tonë, ndoshta unë kam veprue pak ma ndryshe, e thirra këshillin e prindërve, në të vërtetë, përfaqësuesit e të gjitha paraleleve nga një prind edhe u mbush ajo salla aty ku e mbanin takimin me këtë drejtorin. Edhe mendoj se kjo ishte një ndër elementet kyç që ne t’mos na përjashtojnë nga shkolla.

Shkolla ishte në tre gjuhë, domethanë shkolla “Vuk Karadzić” e kishte mësimin në gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe gjuhën turke, dhe i kishin paralelet speciale të fëmijëve shurdhmemec. Domethanë, një shkollë tejet karakteristike për të gjitha elementet që i kishte më vete. Njerëzit, atëherë filloi diskriminimi në pagesa, në rroga, dhe më kujtohet me një takim që ishte me shoqërinë civile diku në Fakultetin Filologjik kur e kam prezentu këtë, më kanë thanë, “S’është e vërtetë”. Unë kam thanë, “Është e vërtetë se unë vet në shpinën time po e ndjej këtë”.

Patjetër, se nëse kolegja ime paguhet tre fish më shumë se unë, çka është atëherë. Ajo i kishte 22-23 nxënës në klasë e unë i kisha 38-40 nxënës në klasë. Kjo është e pa falshme, a po më kupton? Diskriminimi është i pafalshëm edhe nuk ia uroj askujt edhe nuk dëshiroj që edhe populli im të jetë diskriminues. Shumë jam kundër këtij elementi tejet negativ. Është mbi të gjitha poshtëruar. E pastaj kur e ndanë, këto janë këto elemente shumë të rëndësishme. Kur e ndanë, se paguheshte edhe shujta si mënyrë e veçantë, i shoh dallimet si zëvendës drejtoreshë, i shoh dallimet në pagesa edhe unë e refuzoj timen. I them, “Nuk e dua, nuk e dua se keni futë lugën në pjatën time”. Domethanë, po ma hani bukën atëherë hajeni krejt, ngopuni krejtësisht.

Edhe këtu filloi ndarja, krejtësisht u ndamë. U ba caktimi, fëmijët që të paraleleve serbe mësonin në katin e epërm, që ishte pjesa ma e ndritshme ma e bukur, shqiptarët poshtë në përdheshë, turqit i ndanë me ni anë tjetër krejt. Paralelet speciale mbeten në kat. Por, se diskriminohet edhe fëmia i cili ka probleme jetësore, ata kam pa vetëm aty. Kur e mbyllnim klasën me ndrrimin e parë e në ndrrimin e dytë fëmijët shqiptarë nuk mund të hynin më brenda. Kjo ishte shumë e dhimbshme. Pastaj zbritën erdhën te unë edhe kërkuan që, “Nuk po dojnë naltë, po dojnë poshtë. Të jemi me të tjerët” {Bën shqiponjën me duar}.

Ne kishim shumë probleme hapësinore në atë kohë. Dhe jo vetëm probleme hapësinore, po probleme të çdo lloji. Probleme të varfërisë të fëmijëve, probleme të mungesës së teksteve, të mjeteve mësimore që na patën mbetë krejt lartë. Unë kam pasë shumë material edhe për fat të keq krejt është i dëmtum. I ruhësia hartimet ma të bukura të nxënësve, kshtu të veçanta, krejt çka kanë punue në dollapin tim. Ato krejt kanë shkue. Por kur ka ardhë koha që t’veproj njësoj, unë atë nuk e kam ba. Kam thanë, “Unë nuk do t’sjellëm si janë sjellë ata”.

Ma s’pari vetit ia kom dhanë për detyrë edhe të gjithë materialet që kanë qenë në gjuhën serbe, libri amë në gjuhën serbe, krejt përmes UNMIK-ut atëherë jemi takue me ish drejtorin që ishte në shkollë,

që duhet t'jem shumë e sinqertë, ka qenë një njeri, ky është drejtori i dytë i dhunshëm që ka ardhë në shkollë, ka qenë krejtësisht i ndryshëm nga ai i pari dhe me të cilin edhe kemi bisedu. Jemi marrë vesh qoftë për nxemje, për rrymë, për t'gjitha, se ai kërkonte të marrë pjesë në pagesë, me çfarë logjike? Edhe ashtu që, unë atij ia kam dërgu të gjitha. Edhe i kam thanë, “Qe ku i ke, unë nuk kam dashtë të sjellem siç jeni sjellë ju”. S’paku e kam thanë në sy drejtpërdrejt.

Kjo është ajo periudha kur nuk dinin, jetonim sot për sot, nuk dinim çka po na pret e nesërmja. Thjeshtë nuk dinim. Edhe kur thuhet mësimi paralel, mendoj se Kosova kurrë nuk ka ba mësim paralele. Kosova ka punue sipas planeve dhe programeve të përcaktuara me programe të Kosovës. Paralel ka qenë sistemi që ka dashtë të imponohet. Unë ashtu e shoh dhe... se ti nëse thu na kemi punu në sistemin paralel, ajo domethanë se ti po e pranon që ka qenë si shtet këtu edhe ti tash je paralel me ta. Jo, ata ta kanë imponu paralelizmin, ata janë paralel nuk je ti, se ti je këtu, ti je autokton me të gjitha dokumentet që ishin zyrtare që rrjedhshin nga ligjshmëria e asaj kohe. A hyna paska në politikë? Po më duket po (qeshë).

Anita Susuri: Janë vitet e ‘90-ta që ka pasë shumë ngjarje politike deshte apo s’deshte.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Ju e di që keni marrë pjesë edhe në shumë protesta që janë organizu prej grave. Si keni hi në ato rrjedha? Si kanë fillu kto?

Greta Kaçinari: Atëherë këto filluan organizimi... ma s’pari ka qenë Lidhja Demokratike e Kosovës, domethanë si bërthamë e krejt asaj se... e krejt lëvizjës së viteve ‘90-ta edhe kjo nuk mund të mohohet. Grupi i Grave që ka qenë për brenda Lidhjes Demokratike, ka qenë një grup i fuqishëm. Normal, ato i kanë zbatue të gjitha ato programet të cilat i kanë pasë në programin... ajo s’ka qenë, në fillim nuk ka qenë lëvizje. Dhe, domethanë e para ka qenë bashkëpunimi me këto gra. Pastaj kanë fillu të krijohen grupe të tjera, ta marrim grupi i [Flora Brovinës](#). Pastaj, kështu grupe-grupe kanë fillue gratë të organizohen në sfera të interesit, qoftë profesional, qoftë, edhe është deshtë që krejt këto diqysh të jenë të bashkume.

Atëherë, në një takim, ku kemi qenë tri veta, këtë duhet ta them publikisht, pa emra, grupi... Rrjeti i Grave në Beograd kërkon nga gratë tona t’i bashkangjitemi këtij rrjeti. Bashkëpunim me ta. Na trija po e bisedojmë këtë, edhe une them, “Qysh? Ata rrjet, e na çka jemi? Na nuk kemi rrjet. Vetëm kur do të kemi rrjet mund të mendojmë për bashkëpunim. Tash për tash nuk kemi rrjet. Unë për vete mendoj se nuk duhet ta pranojmë këtë bashkëpunim në këtë nivel”. Vje bashkëshorti i njanës prej tyne edhe thotë, “Pse çka ke ti kundër bashkëpunimeve?” “Jo, jo, kundër bashkëpunimeve nuk kam asgjë, por duhet të jemi të barabartë, qoftë në emërtime”.

Pas dy jave është thirrë takimi i të gjitha grupeve të mundshme edhe është formu ai Rrjeti i Gruas. Është formua Rrjeti i Grave. Këtë po e them se më duhet ta them, emri im nuk është përmend kurrë as

nuk dua të përmendet, por është diçka që nëse një ide është e shëndoshë ajo e merr rrugën e vet në të gjitha aktivitetet. Kudo që m'kanë thanë se a po vjen, une kam shkue. Nuk kam qenë udhëheqëse asnjë grupi, për mua primare ka qenë shkolla. Edhe, por edhe në shkollë i kam pasë rastet të shumë vizitorëve të huaj.

Më kujtohet më kanë ardhë edhe prej Serbie edhe m'kanë pytë... po tash po mendoj se këta kanë qenë opozita [e Millosheviqit] apo çka ishte atëherë edhe ishin të interesum me pasë informata. Pastaj, nga të gjitha vendet europiane edhe falë gjuhës angleze komunikimi ishte i drejtpërdrejt. Unë nuk kisha asnjë arsye, asnjë të pavërtetë me thanë, se atëherë në atë kohë ishin të gjitha të vërteta, së paku ato që i përjetonim. Çfarë bënin të tjerët, le të mbetej atyre që kanë ardhë me pytë se çfarë po ndodhë. Për shkak se, unë asnjëherë s'kam thanë na kanë ba serbtë këte, na kanë ba ate. Jo. Është kjo çka po na ndodhë, kjo është që ka fillu prej kësaj periudhe deri më sot.

Bile, shumë interesant është njëra m'pat pytë, ni suedeze thotë, "Çfarë ngjashmërie kanë gjuhët tuaja? Gjuha sllave, gjuha serbe me gjuhën shqipe?" I kam thanë, "Ngjashmëri sikur gjuha suedeze me gjuhën kineze". Domethanë, krejtësisht të ndryshme. E normal atëherë ia kam shpjegju pak trungun e famshëm të gjuhëve indoevropiane, e që këtë duhet ta dinë të gjithë, apo? Dhe pastaj, ngjarja tjetër që ishte shumë interesante... aha, harrova me tregu se në një periudhë kohore kam qenë e angazhume edhe në Partinë Shqiptare Demokristiane. Ku donim të formonin Forumin e Gruas, unë kam qenë kategorikisht jo se çka duhet forumi i gruas përbrenda një partie politike? T'lutem. Pse i burrave dhe i grave? Kur një parti politike e ka një emër edhe aty nuk ka nevojë të ketë ndasi gjinore.

Mund të ketë detyra të caktuara për dikë, dikënd, dikënd, qoftë mashkull, qoftë femër. Por pse, nuk e di. Atëherë m'kanë thanë, "Jo edhe gjermantë i kanë kshtu të ndara", "E ani mirë, masi doni ndani". Unë qysh atëherë mjaft kam luftue për të drejtat e grave. E di, pat ardhë një, tash pranimi i mësuesave të ri në shkollë, mësime dhanësve t'ri. Në fillim të viteve '90-ta një numër i madh të moshuarve, mësuesave të moshuar, ato u pensionuan. Por, para se ta lëshonin mësimin e kishin n'hall çka me bo tash, qysh? Dhe për fat të mirë e kisha një mësuese të re që vinte të zavendësonte një mësuese dhe une e lus, "Të lutem, a ki shoqe në Shkollën e Lartë e që janë studente të mira e që e kanë krye edhe që mund të vijjnë?" Edhe erdhën ato, shtatë në intervistë. Tha, "Oh, edhe ni djalë", "Jo", thashë, "kësaj radhe nuk du djem".

Për mendimin tem është shumë më mirë të ketë mësuese në klasë të ulëta, mendimi im. Edhe vijne ato, fillojnë të punojnë të shtatat. Domethanë, unë kam pasë aq besim në të, ajo për asnjë moment besimin nuk e ka keqpërdorë. Se i pata thanë, "Shif, ju do të jeni ata që do të jetoni dhe punoni së bashku. Sa më kompakt që jeni, aq ka me qenë shkolla ma e mirë. Sa ma bashkëpunëtor që jeni do t'jetë më mirë". Edhe ato filluan, kur erdhën tash të Shkollës së Lartë profesorat që i përcillnin studentat që vinin në ksi, në praktikë, thanë, "Krejt këto punojnë te ti?" Thashë, "Po", tha, "Po kto i kemi pasë studentet ma t'mirat", "Eh", thashë, "kur kom pasë besim në ma t'mirën, atëherë m'i ka sjellë ma t'mirat".

Por ka pasë raste që e ka pru kërkesën për punësim edhe ka ardhë burri e ka pru edhe kam thanë, "Ju po konkuron?" "Jo valla, qe gruja jeme", "E ku e keni gruan?" "Qe poshtë në kerr", thashë, "A ban zoja

juaj të vije të takohmi?” Vjen ajo, të asaj kohe me ato frizurat të bukura kështu {tregon me duar} të asaj kohe me llokme kështu. Mirë, n’rregull krejt me frizurë krejt. Por unë menjëherë e dija me kënd kam të bëj. Thashë, “M’falni, nëse do t’vije policia, a do t’vini ju t’i ndihmonit shoqes suaj?” Se na pritshim edhe me na hy policia edhe nëpër klasë edhe asine. E nëse një grua që konkuron me një vend pune, nuk është e vetëdijshme me çka do t’ballafaqohet po nuk më duhet. Edhe ashtu që, “Ju faleminderit, kësaj radhe nuk ka vend të lirë”.

Por, ka pasë raste kur unë i kam thirrë n’telefon mbas ni viti dhe ju kam thanë, “A po vini se ka vend të lirë”. Pse? Me ta komunikoj në mënyrë të barabartë në.... Thjeshtë i preksha ato pika që më nevojiteshin t’i kam në shkollë. Edhe ata që ju përgjigjeshin pozitivisht ktyre gjanave, e që ishin biseda krejt, s’kishin të banin me shkollën po me jetën, atëherë unë ua mirrsha numrin e telefonit edhe kur kisha nevojë i thirrsha eja. Me këto krejt, paksa, Drejtoria e Arsimit atëherë nuk ka qenë dakord edhe unë kisha goxha *clashes* [Eng.: përplasje] me ta. Nuk ju lejoja t’mi impononin njerëzit t’mi sjellin në shkollë, ku po di unë kënd do t’ma bijnë, kështu vet.

E vetmja që jepsha përgjigje për shkollën, e vetmja që luftojsha për shkollën. Edhe pastaj erdhën këto vite të vështira, gjithmonë në bashkëpunim me të gjitha grupet e grave, Rrjetin e Grave, me... në të gjitha takimet që ishin me përfaqësues të jashtëm, me të cilët, të cilëve ua prezentonim problemet tona dhe... e tash ku me i mbajtë krejt emërtimet në mend të këtyre... Ishte atëherë një organizatë ndërkombëtare, e cila e kishte zyret në Prishtinë dhe unë si përfaqësuese e PSHDK-së në këtë takim, çka kam unë me folë për parinë politike? Ishin ata dy tjetër që folën, unë fola për shkollën edhe tregova që kemi klasa speciale të fëmijëve që kanë pengesa me dëgjim.

Dhe ata thanë, “Ne s’e kemi këtë informatë”, une thashë, “Pse a ju i keni t’gjitha informatat?” “Po”, tha, “i kemi, por për këtë nuk kemi informatë”, tha, “Bisedojmë mbas një jave”. Mbas një jave ka ardhë në shkollë, tash përfaqësuesi i një organizate, organizate bëmërese nga, ai ishte francez ai djaloshi. Edhe ai na ka sigurue naftën për krejt dimrin, bile edhe për, nxeheshin edhe serbtë nga ajo naftë edhe turqtë nga ajo naftë, në shpinë e asaj të fëmijëve me nevoja të veçanta. Tash, merre me mend a! Edhe kanë pru, thanë, “Jemi të gatshëm me sjellë edhe një ton ushqim”, une ju kom thanë, “Jo një ton jo. Një ton është shumë, a bon gjysmë toni?” Po nuk kisha ide sa është ajo.

Edhe e kemi rregullu ndarjen e këtij materiali, se ni prind që banonte afër shkollës e liroi bodrumin që e kishte të rregulluar për banim {shpjegon me gje}, ishte shumë i pastërt edhe krejt atë material e kemi vendosë aty. Dhe filluan ta bëjmë listat e nxënësve që kanë nevojë. Më beso, nuk ka pasë diçka ma t’prekshme se kur kemi fillu t’i ndajmë pakot, se mbledhet krejt mjerimi në një vend. Atëherë kishim një mjek që punonte në shkollë, i kishim atëherë mjektë, një motër medicinale edhe unë. Na, neve kurrë sytë nuk na u kanë terë t’u qajhtë derisa i kemi shpërnda ato materiale krejt. Ka qenë një pikë tejet e dhimbshme, tejet e dhimbshme. Edhe...

Anita Susuri: Në cilat organizime të Rrjetit të Grave ju keni marrë pjesë? Në cilat protesta apo marshe?

Greta Kaçinari: Në të gjitha të mundshmet që kanë qenë. Por, ai i fundit edhe të gjitha protestat kanë qenë masive. Për fat të keq unë nuk kam mbërri të jem në protestën e bukës, po për shkak se isha

shumë e sëmure ato ditë, kisha temperaturë të lartë edhe.... Por isha në takimet paraprake që kishim me përfaqësues amerikanë, anglezë, francezë, të peshit tash të famshëm. Por ata ishin të zyrave të tyre dhe të cilëve... pas kësaj ka qenë pastaj kjo protesta masive e grave. Rrjeti i... gratë kanë luftë një rol shumë të madh. Ta them edhe këtë, paksa kam fillu t'i harroj emërtimet e grupeve të ndryshme që kanë qenë. Ka qenë një grup shumë karakteristik që ka ndihmë gratë që kanë jetue vet apo që kanë përjetu dhunë në familje, që ma vonë kjo është zhvillue në një shkallë shumë të mirë të lartë, ende jo të preferueshme.

Por, kur njëra prej tyre edhe unë më ra disi hise të jemi me dy përfaqësuese kanadeze, dy përfaqësuese të parlamentit danez që ishin në Kosovë. Ishte periudha dikund para kërshëndellave, para vitit të ri apo mes kërshëndellave edhe vitit të ri erdhën këtu në Kosovë. Por, ato kanë ardhë me një, i ka ftue dikush tjetër e që ishin serbtë dhe kto ishin të vendosura në Hotelin Grand, ku shqiptarët nuk hynin më. Dhe ne të dyjat, me i përcjellë këto gra se ju kanë thanë se romët janë të diskriminuar nga shqiptarët edhe e para çka ishte ishte të vizitonim shoqatën “Nënë Tereza”, ishin aty. Pastaj shkuam në spitalin “Nënë Tereza”, që ishte spital në shtëpia private. Edhe sa hynën në derë rreshti ishte, unë tash nuk e di a kanë qenë romë, a ashkali a kanë qenë egjiptianë, por gratë kanë qenë aty.

Edhe kto mbetën, hynën brenda, vetëm kur ka dalë njëra prej tyre thotë, “Unë, më duhet pak ujë se po don t'fikët me m'ra”. Aq u shqetësuen, aq u prekën tejet kur e panë krejt, se aty edhe lindeshin gratë edhe bëheshin vizitat mjekësore, kijamet ka qenë. Tu u kthy prej spitalit tash po i çojmë në hotel. Po i dërgojmë në hotel edhe na të dyja ishim edhe të veshura edhe të shminkuara edhe të rregullume edhe tash po ju themi, po ju them unë se, thashë, “Këte që ju rrëfyem nuk është ajo që shkon me atë se si dukemi ne. Por ta dini se edhe kjo se si dukemi edhe shminka jonë janë një element i luftimit të krejt kësaj gjendjeje, sepse me këtë i jepim vullnet vetit. Përmes nesh, vullnetit tonë, i japim vullnet edhe të tjerëve”.

Ajo që ishte e ulne afër shoferit e nxorri buzëkuqin dhe i lyu buzët e veta. Shumë interesant ka qenë kjo se edhe vërtetë krejt gratë tona tip top, s'ka me lëshu pe, hiç, kërkund. Edhe ni segment politik të krejt kësaj ishte që, ishte një emision i famshëm në atë kohë kur e dha Televizioni i Prishtinës të asaj kohe që ishte nën okupim dhe që ishte edhe intervista me mua. Kjo ishte, intervista u mbajtë në zyrën, ishte zyra ime, zyra arsimtarëve krejt ishin në një dhomë. Rrinim bashkë. Edhe ata erdhën për me më intervistue edhe me m'pytë se si na po punojmë kështu të ndarë në shtetin serb. Edhe unë e kam dhanë mendimin tem rreth kësaj edhe mandej m'thojshin, “Qysh bre i numërojshe me gishta?” (qeshë). Po sidoqoftë, kjo intervistë pastaj e ngriti popullaritetin tim në lagjen ku isha, dhe jo vetëm në lagje.

Se e di që Anton Çetta më pat thirrë, gjithmonë më thoshte, “A more dreq i vockël” edhe me m'thanë se, “Deri tash t'kom thanë dreq i vocërr, tash po t'thom engjull”. Ishte prek shumë prej asaj çka ka dëgjue. Unë vetëm i kam lutë këta që asni fjalë të mos ma ndryshojnë dhe mos t'ma prejnë atë çfarë ka qenë në intervistë dhe që e kanë ba. Një pjesë e kanë pre kur kam folë për rroga që i kemi krejt të ndalura rrogat dhe, “Se shpresoj se ato rroga nuk do të shkojnë për armatim”. Kjo ka qenë e preme e krejt kto tjerat po, kanë shkue *live*. Kur e thashë këtë domethanë përmes Partisë Shqiptare

Demokristiane, unë kisha pak njëfarë *rating*-u këtu edhe u zgjodha edhe anëtare e Asamblesë së Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Dhe gjithmonë harroj këtë me cekë. Pse? Se ishte periudha. Ajo çka mbaj mend është ajo që kur e kemi mbajtur takimin e parë në zyrat e, aty ku i mbante takimet presidenti Rugova, na u mblodhëm aty, kanë ardhë tanksat e policitë edhe e kanë rrethu vendin. Dhe atëherë zonja Kelmendi, Nekibe Kelmendi, e ka thirrë Zyrën Amerikane dhe ata kanë ardhë menjëherë. Kanë intervenu që kta t'mos intervinojnë. Ka qenë njëfarë *clash* [përplasje] shumë i madh, dhe mu më kujtohet ka qenë moment interesant se ne dilnim me letra në dorë nga ai takim përballë tanksave dhe tytave të kthyer nga hyerja e këtij vendi ku është mbajtur takimi.

Mandej roli i Kryqit të Kuq në këtë periudhë, roli i... shif, të jetosh në shkollë, të punosh në shkollë në periudhë dhjetë vjet në këto kushte është si të jetosh njëqind vjet në kushte normale. Ka qenë e përfshirë një histori e tërë e asaj se çfarë ndodhte. Është... aty duhet me shku me shkrujtë ditë për ditë ose kur fillun të vijnë të shpërngulurit nga Drenica, nga ato vendet ku kishte fillue '98-shën trazirat, kur kishin fillue vrasjet, kur filluen të vijnë nxënësit, familjet vinin të lëviznin në Prishtinë. Më kujtohet kur një mësuese ka ardhë dhe m'ka thanë, "Unë nuk mund t'punoj me 60 nxënës, me 60 fëmijë në klasë. Ne nuk kishim kohë t'i evidentonim të cilët janë ata që na vinin". Rrinin dy ditë edhe shkonin, vinin tjetër.

Ishin një fluks i jashtëzakonshëm. Thashë, "Çka? Çka po don me i mësu ti këta fëmijë?" tha, "Po shqip edhe matematikë", "S'ka shqip, s'ka matematikë. Tash ki me i mësue qysh me e dashtë njani-tjetrin. S'ka mësim ma, na tash duhet për kta fëmijë të kujdesemi kështu, me dashni, me rrëfime, me pozitivitet që fëmijët e traumatizim po të vijnë 60 në klasë, kjo është asi... Ai që nuk mundet le të shkon në shtëpi". Hiç, s'ka pasë pardon. Ti po mban mësim në kohë lufte, se dhjetë vjet kanë qenë luftë, dhjetë vjet, se të më kërkohet një sinti apo një piano në shkollë... çka? Na jemi tash në mal. Në mal a ka sinti, a ka piano, s'ka. Çka do të bëjmë? Do t'mësojmë të këndojmë pa piano, pa sinti, me atë që na ka falë Zoti, me zë, edhe qe kështu.

Mandej shumë ka nga kjo periudhë vërtetë. Një periudhë shumë e dhimbshme. Edhe nuk e tregova edhe rastin kur, kur është emërtue shkolla "Elena Gjika" dhe kur u ba ndarja e kateve. Na ishim në një mbledhje të sindikatës, se sindikata ka punue shumë në atë kohë, ka qenë shumë aktive. Vijnë dy djem të gjatë, të pashëm, shumë të mëdhenjë. Edhe unë t'u kujtu që njëri prej tyre është i fejumi i njërit prej mësuesëve që i kisha. Ju them, "Urdhëroni", ata, "Na folni serbisht. Kush është këtu përgjegjës?" Une po thom, "Une", edhe, "Na vijmë prej punëve të brendshme", edhe thashë, "Uuu {onomatope} ku qenkeni prej kësaj shtëpie, ku qenkeni kaq të gjatë", (qeshë). Menjëherë me këtë. Edhe nganjëherë është mirë me ba kështu se thehet, thehet akulli.

"Neve na nevojitet me e pa librin amë ju shqip qysh po e mbani", "Ne s'kemi libër amë, ne e kemi librin amë të përbashkët". Edhe vërtetë. Te na nuk ka ndodhë që të kemi libër amë të ndarë po në librin amë që e kishim të përbashkët edhe të turqve, edhe të serbëve, edhe të shqiptarëve, edhe të fëmijëve me nevoja të veçanta ishin në një libër të trashë. Ne aty i regjistronim fëmijët. Neve s'na kanë ndalu askush ta bëjmë këtë sepse sekretarin e kishim shqiptar, ai i mbante ata libra edhe na atë punë e krynim aty.

Por problemi ka qenë te dëftesat, se dëftesat ishin të parat që ishin në gjuhën shqipe. E na drejtortë e shkollave e kishim problem për vula. Cilën vulë ta përdorim tash? Se e kishim emërtimin “Elena Gjika”, jo, vulat s’i kishim ende për këto dëftesa e përdornim faksimilin. E njëqind halle derisa u ba ai faksimil me emrin tem edhe shkollën, edhe emrin e shkollës “Elena Gjika”, faksimil. Si mjekëve që i qesin aty emrat. Jo vulë, se vulat nuk ishin ende gati.

Edhe vijnë këta, m’falni faksimili ka qenë një vjet përpara, ky tash, kta kanë ardhë për vulë. Edhe na kanë thanë, “Ju po e përdorni ni vulë”, une kam thanë, “Po, vulën e shkollës ‘Elena Gjika’” edhe thotë, “Neve na duhet ajo vulë”, unë kam thanë, “Unë atë vulë nuk e kam në shkollë, por e kam në shtëpi për shkak se jam përgjegjëse për atë vulë edhe ktu nuk kam vend ku ta lë. Nuk kam as syzë time, fijkë timen ku me vendosë me çels, as atë nuk e kam. Prandaj, kam qenë e detyrune ta mbaj në shtëpi të sigurtë”, atëherë ai tha, “Na do të duhet t’vijmë ta marrim në shtëpi”. Shkojmë në shtëpi tek unë.

Ata t’u e hapë derën e kerrit po më thojnë, “Na falni zonjë, nuk e kemi ditë se do të vozisim një zonjë e automobilin nuk e kemi të pastërt”, “Hajt”, thashë, “mos keni dert se edhe ashtu keni të bëni me një mini zonjë” (qeshë). Unë ktu iu bisha {shpjegon me dorë, tek beli}, më besoni, ata dy metrasha. Edhe ata tash njëri qeshtem tjetri serioz. Erdhëm, tash t’u ecë rrugës, ai njëni po m’thotë, “Po zojë”, tha, “çka është kjo kështu? Pse po i boni krejt këto probleme pa nevojë?” Thashë, “Qysh mos me bo probleme? Kqyre shkollën “Faik Konica”, i kanë qitë fëmijët krejt prej shkolle”. Në Faik Konica, asni shqiptarë nuk ka pasë, sa gjyna. Në atë kohë krejt fëmijët kanë qenë të shpërndarë nëpër shkolla të ndryshme.

Edhe thashë, “E kta që janë të përjashtum? E atje që është ndërtu muri në shkollën në ‘Dardani’?” Thashë, “Kto nuk janë në rregull”, “Jo bre, ajo e kësaj shkollës ‘Aca Marović’” tha, “Ajo nuk është në rregull”, tha, “Ajo drejtoresha”, thashë, “N’veti pa vete, ajo i ka hjekë fëmijët prej shkolle”, tha, “Po zojë”, tha, “Nuk munden dy shtete me ni shtet”, thashë, “Ktu pajtohem plotësisht”. Se edhe e tij ishte me dy thika, po edhe përgjigja ime ishte me dy thika se edhe pajtohesha.

Mrrinëm këtu te dera, po tregoj këtë se ishte shumë interesant, para se me hye në hyrjen kryesore poshtë, po ju them, “Kqyrni djema, kjo që ju do të hyni në banesën time është vetëm vullneti i mirë i imi që po ju lejoj të hyni”, une në atë temën t’u i ngacmue (qeshë). Ata edhe qeshën. Bile, bile me za qeshën. Hynëm na brenda erdhëm këtu. Në këtë, në mur e kam pasë një telefon ai të murit, grek ishin përpara, një i portokalltë edhe mbi të një letër e shkruar një thënie që e pata dëgjue në një film tejet të bukur. Ku, në Skoci ka ndodhë kjo edhe unë e kam shkru atë në letër edhe atë letër e kam vu te telefoni. Për asgjë hiç e kam vu aty se m’ka pëlqy shumë.

Ku shkruante, shkruante, unë nga titllimet serbisht e kam shkrujtë serbisht edhe serbisht ka qenë e shkrome. A te them shqip a serbisht?

Anita Susuri: Si t’doni, si t’ju vjen ma lehtë.

Greta Kaçinari: “*Da Bog da se sećali ovoga do god živite*”, e mbashi mend këtë derisa të jetoni, duke u turpëruar, aha, “*Da Bog da se sećate stideći se*” [Dhashtë Zoti ta kujtoni duke u turpëruar]. Edhe ata

hynë brenda edhe e para ka qenë ajo që e lexojnë atë. Merreni me mend, çka kanë lypë ata në banesë time? Hajt kallxom ti mua. Bash s'kanë pasë nevojë të vijnë. Kanë mujtë me thanë na bjerë atë vulen. Edhe e para që kam ba e kam marrë vulen prej dhomës t'fjetjes e kom pru mbi tavolinë edhe kam thanë, "Qe ku është vula" edhe, "E dëftesa?" "E dëftesa", thashë, "S'ka. Dëftesat janë të shpërndara tek nxënësit". Edhe që ishte e vërtetë. Edhe ata e morën vulën.

Unë iu thashë, "Mu m'duhet ni vërtetim që ma keni marrë këtë vulë", tha, "Qysh zojë? Po na s'japim vërtetime". A din, thashë, "E unë qysh do ta mbuloj atë që s'e kam ma vulën?" "Masi do t'vini pas dy ditëve te ne", tash po m'thojnë, "Atëherë do t'flasim për këtë", e unë po ju them, "E pse me ardhë? Unë qat' ditë e kam caktue datën e këshillit të arsimtarëve", ai tha, "Eh po, shtyje një datë këtë mbledhjen e këshillit të arsimtarëve se ju duhet të vini tek ne". Edhe une shkoj atje.

Çka ka ndodhë në ndërkohë, kjo është viti '92... në fund të majit më vdiq baba. U ndërpre në të gjitha komunikimet me Bosnjën deri në '95-tën unë nuk kam ditë, domethanë i kam kalu dy lufta, nuk kam ditë a i kam gjallë, a s'i i kam anëtarët e familjes sime. Domethanë, vllazërit, nanën, babën. Baba vdiq. Para kësaj bisede që e tregova tash, më vdes halla në Prizren. Te baba ma nuk kam mund të shkoj në vorrim edhe pse '92-shën e kam... vllau për herë t'fundit kur kam folë në telefon i kam thanë, "Po vi unë", m'ka thanë, "Mos eja!" "Po vi une," [vëllau më thot] "se tani autobusi i tërë është zhdukë i njerëzve, ti s'ke qare pa kalue nëpër Beograd edhe nëpër Bërkço", se ashtu ishte rruga.

Po thashë, "Une do ta thrras Vlladikën", s'po ia tregoj emrin se po më vjen keq, thjeshtë. "Do ta thrras atë, ai do t'na ndihmon që të jemi bashkë në vorrimin e bacës", tha, "Mos e thirr", tha, "Se ai nuk është ma i njeiti qysh ka qenë". Edhe kjo më ka dhimtë në zemër se shumë e kemi dashtë. Këndonim bashkë, ai këndonte shumë bukur. Mendoj se është pendue për atë që ka bo në atë kohë të pa kohë. Nuk e kam pa kurrë ma. Edhe më vjen shumë keq për shkak të atij edhe për shkak të shpirtit të tij. Se në atë kohë kur jetonim në Tuzëll edhe bashkëpunonim edhe Kisha Katolike edhe Kisha Ortodokse edhe përfaqësuesit e fesë islame, të trijat përpiqeshim që të kemi... unë isha e re atëherë i kishim grupet rinore bashkëpunonim mes vete. Edhe kjo ishte një gjë shumë e bukur.

Domethanë, tash baba më vdiq, unë nuk arrita të shkoj. Halla më vdiq, dy hapa prej Prishtinë në Prizren edhe unë nuk shkoj në vorrim të hallës. Se e kam ditë, nëse do t'shkoj do ta qaj babën, do ta qaj hallën, do ta qaj vetvetën, do t'i qaj të gjithë ata fëmijë që i kisha në shkollë, do ta qaj fatin tim thjeshtë për qat' kohë e unë nuk kam dashtë të shkoj e lodhur në këtë takim me këta dy djemtë, këta dy UDBA-shat. Dhe nuk shkoj. Edhe shkoj e shminkume, e rregullune si gjithnjë.

Edhe ma kanë dhanë vërtetimin e shkruar shkolla fillore "Elena Gjika", mësimi në gjuhën shqipe, serbisht e formulune. Dhe meqë në atë kohë ne nuk kishim mundësi t'i fotokopjojmë këto, mu më vjen keq, atë dokument nuk e kam. Por e pata dorëzu në Kishillin për të Drejtat e Njeriut që kam bashkëpunu shumë me ta edhe shpresoj ta kenë ata dikund atje. Por, sidoqoftë, sekretari i shkollës dhe unë në këtë takim kemi ndejtë pesë orë e 15 minuta dhe kta njëherë njani dilte, tjetri hynte.

Po ju thom, "Pse bre ju djem herë njani po del tjetri po hyn?" "Po", tha, "po referojmë te shefi", "Po le t'vjen shefi ktu edhe të gjithë s'bashku ose t'shkojmë na te shefi s'ka nevojë hyn e dil". Qëllimi i krejt

intervistës ishte që të flasim, për shembull, m'kanë pytë, "Kush ta ka dhanë vulën?" Unë i kam thanë, edhe vërtetë ashtu ka qenë, unë mezi kam pritë për këtë vulë. Kam hy në zyrat tona që ishin atëherë të këshillit të arsimit, kom hy edhe t'u i çelë e kam gjetë vulën teme. Edhe vetëm me një fletë ku janë nënshkrue, jam nënshkrue se e kam marrë. Kërkush mua s'ma ka dhanë atë.

Edhe unë po i them, "O njerëz kërk..." që kshtu, iu rrëfeva sikur juve tash. Edhe tha, "A ke qenë në zyrën e filan fistekut?", "Paj, ajo zyrja është ku ai punon por punojnë edhe të tjerët, nuk është vetëm e tij". Domethanë, emrat, kërkonin emra të veçum. Edhe jo vetëm kjo, po edhe për shumë gjana tjera pytshin, për, për si jemi organizue, çka jemi t'u ba në shkollë, qysh po shkojnë puntë me atë drejtorin serb? Vetëm i thashë, "Unë atij drejtorit tuaj i kam thanë le te hjekë Millosheviqin prej sallës t'vet le ta mban "Vuk Karadzić". Shkolla e ka emrin Vuk Karadzić nuk e ka Slobodan Millosheviq".

Edhe vërtetë i pata thanë ashtu, "Hiqe këtë njeri këtu, që ku e ki emrin e shkollës edhe mjafton kjo", po tha, "Jam me partinë e gruas së tij", thashë, "Njësoj janë se a flejnë me një shtrat? Të njëjtë janë". Po sidoqoftë të dytë kanë shkue në atë dynja, i gjykon dikush tjetër. I gjykoj edhe këtu bota, por sa gjyna është për njerëzit që e dijnë vetën që janë në një situatë të gjykuar nga bota, nga Zoti po se po.

Pjesa e Gjashtë

Greta Kaçinari: Kur filloi lufta, kur filluan bombardimet e para... po ashtu një periudhë e vështirë dhe rëndë. Ne ishim tre veta, domethanë Gjergji, unë dhe Klorinda, na të tretë. Edhe erdhen kojshitë edhe po i bijnë derës e po thojnë, "Na po nisemi. Hajdeni edhe ju me neve". Shkaku që mos të dalim ka qenë vajza. Pse? Vajza thotë, "Mam, na jemi tre veta ata janë krejt kah pesë, kah dhjetë veta". Domethanë, familje të mdha me fjalë tjera. "Na jemi tre veta, nuk po dalim. Nuk po shkojmë kërkund". Edhe kjo ishte shkaku që kemi mbetë. Domethanë, që kishte të drejtë se dikush duhet të sakrifikonin në një farë mënyre.

Por, kur kanë fillue bombardimet, prej dhomës së fjetjes së vet ka ardhë tek ne të dy në shtrat edhe u fut në mes. Momente jo të mira, të vështira. Domethanë, ne gjatë kësaj periudhe, të kësaj pjese më të përgjakshme kemi qëndru në Prishtinë. Bile, bile, mua më ka ndodhë që më ka pëlqitë edhe ulçera dhe u deshtë të operohem në spital. Por, diçka nuk mund të mos e përmendi këtu se stafi mjekësor i cili ka qenë edhe të gjitha, stafi teknik domethanë, motrat medicinale kanë tregue një kujdes të jashtëzakonshëm që unë sot jam gjallë.

Anita Susuri: Kanë qenë serbë apo?

Greta Kaçinari: Të gjithë serbë. Edhe unë këte nuk e harroj kurrë, për shkak se në... e çka, një diçka tjetër interesante me këtë periudhë, para se të më vëjnë në operacion, ma kanë caktue dikë tjetër me më operue, jo ai mjeku që unë doja, e që ishte një boshnjak i Malit të Zi edhe që ishte shumë i njohur atëherë. Por thojshin, "Te ai me shkue, ti duhesh me i dhanë njëqind", ksine, çka ishte atëherë? Çfarë

përdornim? Jo euro po, “Njëqind marka ti duhet me ia dhanë”, unë i kam thanë, “Asni dinar s’du me ia dhanë. Kurrë askujt, jo vetëm atij”.

Edhe unë insistoja të jetë ai edhe vje një mjek i ri tash edhe m’sheh t’u qajtë e shqetësime edhe m’thotë, “Çka keni?” Serbisht ka folë. Po ai kishte qenë fëmijë i prindërve të përzier, shqiptar e serb, nuk ia di emrin. Dhe thotë, “Çka keni zojë?” Serbisht m’thotë. Unë them, “Po më shtijnë me dhunë në operacion”, tha, “Kërkush juve me dhunë s’ka me ju shti në operacion”. Edhe m’ka kap edhe m’ka çu në dhomën time. Derisa nuk e kanë lejuar qat’ mjekun që e kam kërkue unë. E atëherë ai më ka operue. Dhe falë atij që unë jam ende sot gjallë këtu.

Ai mjek mandej u detyruar të largohet nga spitali sepse ishin asi punë, tonët e morën në dorë krejt. Nuk pajtohem me kësaj gjana. Ata që janë të vlefshëm, leni aty. Edhe unë isha në kontrollë edhe ishte mjeku, ai që ma ka operu, edhe ishin mjekët e rinjë që tash ishin mjekët shqiptarë. Edhe unë iu them se, “Falë këtij unë jam sot gjallë. Por ju mësoni nga ky sa të mundeni”. Edhe normal që e falënderoj edhe njëherë këtë mjekun. Atij më vjen shumë keq po kisha me ia çue një *whisky* në fund për falenderim, por as atë s’kam mbri me e ba se...

Por atë çka ma vonë kam përjetue, vitin e kaluar në spital janë dy botëra të ndryshme. Janë dy botëra të njerëzve të përgjegjshëm që e respektojnë punën, e respektojnë sistemin e vet dhe tenetojnë këto gjëra. Më vjen keq ta them këtë, sepse tre muaj ditë të vitit të kaluar, e di shpirti im nëpër çfarë kam kaluar. Jo personalisht, por për burrim tim Gjergj. Dhe uroj që gjeneratat e reja ta kuptojnë këtë, që rruga në QKUK ta... që është e emërtuar Rruga e Hipokratit të jetë vërtetë rrugë e Hipokratit, dhe ai vend të jetë vërtetë ku do t’i përmbahen betimit të Hipokratit. Jo A-jën ta shndërrojnë në I.

Anita Susuri: Ishim te koha e luftës, thatë që keni qenë në Prishtinë.

Greta Kaçinari: Po.

Anita Susuri: Si ka qenë në Prishtinë gjatë luftës?

Greta Kaçinari: Pos asaj periudhe që isha në spital, po i kthehem tash përditshmërisë kur duheshte të furnizohemi me ushqime të ndryshme. Në treg tregonte, se Gjergji ishte ai i cili dilte për furnizim, tregonte se në treg, në këtë tregun e gjelbërt që është, jo tregun e gjelbërt po tregun që është përballë postës.

Anita Susuri: Tregu i Ulpianës.

Greta Kaçinari: Tregu i Ulpianës, aty kishte të gjitha llojeve të rrobave, pajeve të nusërive të varuna për t’u shitur. Merreni me mend, domethënë krejt ato që janë vjedhë nëpër shtëpia. Mandej erdh, këtu e kemi pasë një familje shtatë anëtarëshe, ka ndërtë një javë ditë derisa ka ardhë njani për me i bind që duhet të dalin edhe ata kanë shkue. Kjo ka qenë diku periudha prilli ka qenë taman, fundi i prillit, para se të shkoj në spital. Edhe furnizimet i bënte Gjergji. Kur vinte në shtëpi tregonte se është dashtë të pret këtu në rend për bukë, e këtu për këtë, e për këtë.

Mandej ishte edhe ni element tjetër që nëpër shtëpia, nëpër banesa kishte studenta që nuk kishin, ata nuk kishin tash bukë. E në lagjën tonë u organizojshim edhe mbledhshim bukë edhe gjalpë apo çka kemi pasë në shtëpi për me iu dërgu edhe atyne. Normal kemi shiku që edhe vet mos të mbesim krejt keq. Kështu, një ditë kur doli Gjergji për të blerë gjësende e kanë marrë policia, unë në këtë kohë isha në spital, e kanë marrë policia e kanë mbajtur mbi pesë orë në një vend të, ktu te, si quhet tash...

Anita Susuri: Në Prishtinë diku?

Greta Kaçinari: Po, në Prishtinë, ka qenë një vend shumë famëkeq, si një burg, ama te shkolla "Naim Frashëri", aty në afërsi te shkolla "Naim Frashëri". Dhe tregon Gjergji, në të vërtetë, Gjergji më ka tregu shumë ma vonë. Por vjen vajza të nesërmen në vizitë tek unë edhe unë i them, "E ku o tata?" "Po janë t'u i dhim të dur të diçka shumë", "Pse po i dhamin dur të?" "Bre, mamë", tha, "E kanë marrë dje policia", tha, "e është deshtë tanë kohën t'i mbajë dur të kështu" {shpjegon me duar}. Edhe tha, "S'ka mujtë me ardhën". Ku me ditë është tronditë njeri t'u i mbajë dur të.

Por, këto personalisht nuk e kanë maltretue po çka ka pa ai rreth vetës t'u i maltretue të tjerët që ishin edhe ma të rinjë edhe me... krejt të rinjë e të vjetër. "A e don ni cigare?" T'u i thanë ai polici, ky t'u thanë, "Po bre", "A cigare po don a?" *Bim, bim* {onomatope}. U çmend Gjergji kur i ka përjetu të gjitha këto. Por vajza po m'tregon se... mandej Gjergji m'i ka tregue krejt, se si i ka përjetue krejt këto edhe çka ka pa krejt. Por kta nuk e kanë prek. Askujt emrat nuk ia kanë ditë por thjeshtë ka pasë fat, thjeshtë që është dashtë t'i mbaj duart lartë.

Edhe tash vajza po m'tregon, "Edhe mamë, a din, kanë hy policia brenda", kanë hy n'banesë, "Ani?" Tha, "Po i kanë marrë cigaret, pakot, boksën e cigareve". Na t'zitë e ullinit e hiqeshim për me i gjetë cigaret, ku ka cigare. I kanë marrë cigaret edhe dhjetë euro, dhjetë marka, kanë qenë mbi tavolinë. S'di pse ato [kanë qenë aty]. Unë është deshtë, t'ja japim dikujt ose dikush neve, nuk e di. Por, sidoqoftë. "Ani mamë ani", edhe tha, "Kanë hy në dhomën time edhe krejt kukullat m'i kanë gjujtë në dyshe". Kur t'ja kom fillu me qajtë e qaj e qaj, "E pse kukullat?"

Ato kukulla asnjëna shqiptare nuk ishin, ato shqiptare ishin me veshje dallmatine, me veshje malazise, me veshje kroate, të krejt vendeve të mujshme të ish Jugosllavisë me ksine, me veshje kombëtare të vendeve të ndryshme. Edhe shumë të bukura edhe i kemi ende. Edhe i kanë gjujtë... Po tash krejt ato që më ka tregue për tatën edhe unë fillova të qaj për kukullat. Po nuk ishte për kukullat normal po ishte për krejt situatën. Edhe me rëndësi është që rrymë kishte edhe çfardo që qoftë edhe bukën e futeshim të prerë në riska në friz, që nëse do t'na duhet dhe të mbesim pa të që të kemi. Kështu, nuk e di. Na në familjen tonë e kemi pasë një fat të jashtëzakonshëm se, thjeshtë, nuk e di.

Edhe dy-tre ditë para se kam dalë prej spitalit diku kah fundi i majit, jo besa në qershor, kjo ka qenë në qershor, me 4 qershor, se tash data është atje 4. Erdhën dy policë në banesë te ne edhe fillun regjistrimin në kartela të kaltërta, domethanë emrin, mbiemrin, letërnjoftimi, e tjera, e tjera, të dhënat për të tre ne. Dhe gjysmën e morën për vete, dhe gjysmën na lanë neve. Këto kartela i kam ende edhe sot se janë dëshmi të një kohe të pa kohë. Dhe se tregojnë edhe diçka tjetër që neve kanë qenë si, në

kohën e nazizmit kur hebrenjëve iu kanë dhanë *auswise* [Gjer.: Dokument identifikimi] që të dalin prej vendit ku jetojnë pa ato kartela edhe pa shenjat nuk kanë mujtë të dalin prej vendi. Në të vërtetë ata s'kanë dalë kurrë, por i kanë çu nëpër llogore për Auschwitz e tjera.

Kështu që për mu këto janë dëshmi të një kohe si *ausweis* i Kosovës. I dhanë nga një shtet, nga një shtet pa mendje që për bazë e pat një gllabrim, një urrejtje për zgjerim dhe për fajësim të tjerëve për atë që janë duke bërë, sikur që kanë bërë edhe në Bosnje edhe këtu. Unë nuk e di, ne mbijetuam, mbetëm gjallë dhe... dua edhe diçka të theksoj se, çdo mbrëmje në ora 06:00 vajza edhe unë kemi shku në Kishën e Shën Ndout, kjo kisha e vogël në Ulpianë. Dhe, ndoshta jo çdo natë po sa herë kemi pasë mundësi të shkojmë kemi shkue, dhe kemi qenë pesë-gjashtë veta. Domethanë, një numër shumë i vogël njerëzish që kanë mbetë në Prishtinë.

Kur e kam pytë priftin e atëhershëm, “E ti pse nuk po shkon?” Ai ka thanë, “Po, derisa edhe një mbetë prej jush këtu edhe unë do t'rri me ju”. Edhe... mandej është edhe një element tjetër që fqinjët e lagjës të cilët nuk i kemi njoftë, por që kemi fillu të njoftohemi, jo për këtë lagjen {tregon me duar} këtu njifemi të gjithë, por kjo e epërmja {tregon me duar} që është pak ma e madhe, te shkolla “Ismail Qemali”, është lagje shumë e madhe, po edhe aty kemi fillu edhe me ta. Ashtu që kur erdhën Pashkët, merreni me mend, me i ngjyrosë votë, me çka me ngjyrosë? Ku me gjetë ngjyra? Edhe e gjej një ngjyrë të vetme edhe kta të rinjtë që i kemi njoftue vijnë te ne për festë edhe ashtu që i patëm edhe vetë e ngjyrosura edhe kjo krejt ishte gjatë periudhe të bombardimeve.

Më kujtohet edhe një budallaki t'madhe që e pata ba, se nja tre kufera tesha kanë qenë të gatshme. S'po merrke njeriu asgjë me vete. Domethanë, është një budallak shumë i madh me u lidhë me gjërat materiale kur është jeta në pyetje. Por, mendoj se fotografitë duhet të ruhen edhe eventualisht ndonjë shkrim i veçantë kështu që ka të bëjë me një dokument të veçantë të një kohe të veçantë. Këto janë ato t'bukurat. Edhe, a ta vazhdoj për shkollën ma vonë?

Anita Susuri: Vazhdoni, po.

Greta Kaçinari: Atëherë të parët ishin hebrenjtë që na erdhën, pardon, të parët ishin një shoqatë italiane, të Qiezës, të cilët erdhën në shkollë. Dhe të cilët prunë shumë material shkollor edhe që ai material shkollor është gati, po mos të them, nja pesë vjet jemi shërbye me atë material shkollor. Aq shumë ka pasë edhe tejet, tejet i bukur edhe tejet i mirë. Ma vonë ata na kanë ndihmue me kabinetin e kompjuterave. Kompjuteri kryesor për mësuesin qysh t'i mësoj të tjerët. Ishte çështja që të, që të, arsimtarët të ndihmohen në këtë drejtim që të fillojnë të mësojnë punën me kompjutera. E çohen shqiptartë e zi e vjedhin kabinetin, e qe kështu. Pastaj CDF e cila na ndihmoi për sallën e fiskullturës. Këto janë krejt...

Nuk e di, gabova që i përmenda me emra se ka qenë aq një numër i madh i shoqatave të cilat na kanë ndihmue që unë vetëm duhet ta falënderoj Zotin dhe babën tem që nuk më ka lanë me shkue me studiue në Zagreb, por ta kry gjuhën angleze e të jem në gjendje të komunikoj me njerëz drejtpërdrejt. Kur kanë ardhë hebrenjtë te dera, kanë ardhë te dera, e kanë pa ndërtesa e bukur e “Elena Gjikës”, është shkolla ma e bukura në qytet se i takon një periudhe shumë të vjetër të ndërtimit për të cilën

kam luftue që të hyn në mbrojtje si objekt i vjetër. Edhe që është aprovue kjo nga komuna. Pastaj, hebrejntë e gëlqerosën nga jashtë, temperaturat binin nën -20.

Ka qenë një periudhë e bukur që ta mbush shpirtin, ta mbush mendjen dhe nuk lejon të mendosh gjëra tjera. Pos të bësh dy-tre orë gjumë edhe pastaj të vazhdosh me krejt këtë çfarë ka ndodhë. Një bukuri e hatashme, një mrekulli dua të them. Pastaj, fillun programet kur erdh UNMIK me organizimin e vet. Këtu arsimtarët e shkollës tonë kanë qenë njerëz të mençur që kuptuan që trajnimet e para që kanë qenë të dorës t'parë edhe që kanë qenë të vlere shumë të lartë, se kanë ardhë specialistat të fushave të ndryshme.

Më kujtohet kur ishim në trajnimin e mendimit kritik, unë kam thanë atëherë, "U atëherë prej Rugovës e t'gjithë të tjerë duhet të shkojnë në mendim kritik". Se neve shqiptarëve na mungon mendimi kritik. Thjeshtë na mungon. Dhe ma vonë krejt këta që e kanë marrë këtë bazën e parë të trajnimit, kanë vazhdu me trajnime tjera dhe ka shumë trajnerë prej tyre. Disa janë ba drejtorë të shkollave. Është një punë shumë e mirë dhe desha të them edhe në lidhje me shkollën. Më kujtohet kur në një takim ishte përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit të kohës së UNMIK-ut, kur na mbledh të gjithë drejtorët e shkollave fillore, të mesme.

Krejt kemi qenë në kuvend. Tash merre me mend se sa në kuvend, një sallë e veçantë ka qenë me shkallë, diku kemi qenë. Një numër shumë i madh. Edhe ai thotë... harrova edhe këtë ta them çka ka ndodhë në shkollën time. Për herë të parë janë hapë klasat parashkollore. Parashkollorët kanë ekzistue vetëm me një institut që ka qenë shtetëror. I çonin prindërit fëmijët për qëndrim ditor e ku ta di unë, e ai ka qenë afër shkollës. Kurse si klasë parashkollore janë të parat tek ne. Edhe hapja e këtyre klasave është një histori më vete, krejtësisht më vete.

Edhe nuk e di a ta spjegoj këtë si ka shkue, krejt, si kanë ardhë mësueset të interesune të punojnë, si ju kam thanë që, "Unë nuk di asgjë për parashkollor. Nëse dini më shkruani në letër se çka duhet krejt". Kur vijnë slloventë me i, për me, për mobile shkollorë edhe unë ju them, "Qe i kam këto dy dhoma, por unë nuk e di se çka më duhet këtu". Ata prej Sllovenije, prej Ljublane i kanë dërgue skicat dhe çka duhet për aty.

Kur pas kësaj ka ardhë Caritas i Austrisë edhe krejt kjo ka ndodhë në shkollën time. Unë nuk e di qysh, vinin njerëzia thjeshtë. Edhe më pyesin, "Çka të nevojitet?" edhe unë kam thanë, "Qikjo më nevojitet", {shpjegon me duar}. Edhe kanë ardhë me karriga, me ormana, me tavolina t'vogla për fëmijë t'vegjël. Krejt ato dy dhoma kanë qenë të mbushura sipas asaj qysh e kanë çue sllovent. Krejt t'u i pagu të tjerët, normal. Edhe e ka, për shkollën mund të flas një vjet edhe nuk e di a del mjaft.

Pra, fillova me këto ndryshime menjëherë në fillim të vitit 2000 dhe 2001-shën për herë të parë kam udhëtue për në Bosnje, me nënshkrimin e Kushner që ishte administrator atëherë. Me nënshkrimin e tij kam kalue nëpër Mal të Zi, kam kalue nëpër Sarajevë, nuk e di, kam udhëtue 24 orë. Në Mal të Zi më kanë pytë, "E çka o kjo?" Paj, "Nikad video ovo" kurrë s'kam pa diçka të tillë. Unë kam thanë, "Valla qita ma kanë dhanë" (qeshë). Edhe kjo është hera e parë që kam dalë prej Kosove, domethanë pas dhjetë

vjetve edhe që jam takue me nanën edhe me dy vllazëritë. Me njërin prej tyre për herë të fundit, për herë të parë dhe për herë të fundit. Se ai ma vonë, mandej mas dy-tre vjetve vdiq.

Edhe... atje kam ndejtë një muj ditë, pa e pytë askënd hiç, hiç. As edhe... a dini se si ka kalue ai muaj? Jam kthy krejtësisht në fëmijëri. As nuk kam përmend luftë, as nuk kam përmend asgjë, asgjë nga ajo që kam përjetue, as nuk i kam pytë asgjë çka kanë përjetue, as ata mua. Na në mbrëmje kur vishin prej dyqanit luanim letra, shikonim filma, e këndonim nga një këngë. Kur ata nuk ishin në banesë me nanën, nana luante pasians, i gjuante letrat, një lojë shumë, super lojë është.

E luan njeri vet por edhe tjetri kibicer³, ai që shikon, a din, edhe mundet me reague. E kështu që këtë lojë e luanim Gjergji edhe unë, e herë u përlanim herë u pajtonim. Është një lojë shumë e bukur, por jo në dysh po në njësh. Derisa vëllau nuk m'ka thanë, "Motër, a ki ti me u kthye në punë?" I kam thanë, "Po, është deshë moti të kthehem", "Motër a don me shku me vizitu varrin e bacës?" "Po". Mbas një muaje. Edhe atëherë kam shku te vorri ia kam ndezë një qiri, ia kam thanë disa fjalë. E kam falënderue, ia kam thanë disa fjalë edhe ashtu jam kthy në Prishtinë.

Shikimi i fundit nga autobusi kur ua kam bo me dorë këtyre dy vëllezërve të mi, ka qenë shikimi me këtë vllaun t'cilin e kam pa për herë të parë pas lufte dhe për herë të fundit. Ai mandej ka shku në Opati, atje ka vdekë. Ndërkohë e kam marrë nanën këtu që mos ta la vetëm se kjo veç ishte e sëmurë. Mos ta la vetëm në Tuzëll. Ashtu që, familja ime është ndarë tash. Një është i varrosur në Tuzëll, baba, një në Opati, vllau, dhe nana dhe vëllau i vogël janë të varrosur në Prizren. Të dytë kanë jetue këtu me mua dhe... në të vërtetë vëllau i vogël ka ardhë këtu kur ka vdekë nana edhe unë nuk e kam lëshue që të kthehet atje.

Edhe kështu është jeta interesante edhe ai që mbetë duhet vetëm të falenderoj Zotin për të gjitha dhuratat. Unë vet e falenderoj për të gjitha dhuratat që i kam pasë në jetë. E dhuratat kanë qenë pikërisht prindërit e mi që janë kujdesë për mua, vllazërit e mi që më kanë dashtë. Kur e kanë ba ndarjen e pasurisë, unë hiç as s'kam mendue për atë. Bile, unë e kisha këtë pasuri timen këtu që më ka ndihmu baba në fillim që ta kemi. Ata, krejt ka shkue trisash, merreni me mend. Domethanë, unë si motër ata dy si vllazër, Zoti jem. Çfarë dhurate!

Unë vetëm një pjesë të atyre e kam dhanë tjerat s'ka. Aq sa më është deshtë që kjo pjesa të kryhet këtu se është mbindërtim. Mbindërtim i imponum se s'kishim ne mundësi ta bëjmë ndërtimin, po u deshtë. Se krejt rrotull banën, hajt edhe na, me shtylla, vajza me kredi me këtë ni grimë të ndihmës të trashëgimisë edhe ja kshtu jeta. Edhe për krejt këtë, më besoni, sytë kur t'i hapi në saba i them faleminderit Zot edhe për ditën e sotme edhe për krejt kto ditët nëpër të cilat kam kalue deri më sot.

Mua vetëm më vjen keq që diçka te unë u ndërpre, u ndërpre jo natyrshëm. Unë kam komunikue shumë me njerëz, kam shkue rregullisht në Katedrale... uuu {onomatope} kam harrue edhe diçka me thanë. Deri kur isha drejtor isha drejtoreshë e shkollës kur kërkun që të aplikojnë edhe një herë,

³ Srb. Një vëzhgues kurioz dhe këshilltar i një lojtari gjatë një loje letrash.

domethanë, të aplikojnë për drejtor unë aplikova herë e parë, nuk ka pasë kundërkandidat e anulun. Herën e dytë pat kundërkandidat...

Kundërkandidati ishte i një partie politike, unë nuk dija se ai do t'fitor edhe pse i kam çu dokumentat se pata konkurre. Natën e kërshëndellave shkoj edhe i tërheqi, them, "Dokumentat", "Jo, mos, qysh, qysh ti po tërhiqesh?" "Ami, ti mua dokumentat". Ajo ka qenë për mua thyrja ma e madhe që më ka ndodhë në jetë. M'u thy zemra. Mbete pa ata fëmijë, a po kupton? Se unë kam vazhdu të punoj me fëmijë edhe më vonë edhe pse isha drejtoreshë, hiç.

I kisha grupet që vinin edhe punojshin në zyrën time, vishin me u lavdërue, vishin me u ankue, vishin me u takue me shkrimtarë e tjerë. Dhe, por pas dy vjetve pauzë prapë kam pasë trokitje në derë por ksaj radhe me telefon, "A je e interesume të jesh përkthyes në...?" Vetëm t'më kujtohet, tash ndryshe e ka ndryshu emrin e po imponohet. Mirë, ka të bëjë me gjyqësorin. Edhe unë shkoj atje, takoj njerëz të mrekullueshëm, mësoj për juridikun. Atë ëndërrën e vjetër që kam pasë të studioj juridikun. Nuk mësoj të gjitha, por ato elementaret dhe kam takue edhe dy gjyqtare që kanë qenë të mrekullueshme edhe një prokurore edhe më të mrekullueshme ashtu që unë mësova pak për juridikun.

Pastaj EULEX hapi një konkurs, konkurova atje, nuk e di si arrita edhe u pranova. Kam punu në Departamentin për mjekësi ligjore. Një fushë tash shumë interesant që ka t'bëjë me shumë emocione, me takime me njerëz të personave të zhdukur, me shoqatën e nënave të Gjakovës... mos ta teproj edhe krejt, krejt. Por, ndërprerja ime e fundit është me një shoqatë në të cilën kam qenë iniciatore të themelohet. Është pranë Kishës Katolike këtu në Ulpianë. Sepse ti kur ta mbushës një moshë të caktume, atëherë... e prit se ka me ardhë një moshë tjetër e ma vonshme, jo vetëm e imja. Edhe po i them ni shoqës time, "A din çka? A ta formojmë një grup qishtu grashë të fillojmë të takohemi, ndoshta bëjmë edhe diçka?" "Po, mirë shumë". Po, e pysim priftin çka mendon ai për këtë, ai na përkrahu shumë.

Pastaj kemi bashkëpunue me motrat e Shën Kryqit, ato janë motrat e nderit që punojnë te kisha, nuk punojnë, ato jetojnë aty edhe e kanë domin e studentëve. Edhe qeshtu formohet një shoqatë "Ulrika", ato gratë tash janë gra të moshume, domethanë sa unë. Pak ma të reja që ju ndihmojnë ktyne të moshuarve dhe prej atyre punimeve t'cilat shiten blejnë miell, vaj edhe ju shpërndajnë familjeve të varfëra. Këto kërkund, as nuk bahën publike as... një veprim i duhur njerëzor, human. Ashtu, siç duhet të gjithë të veprojnë.

Kurrë as në televizion as nuk dalin për të qenë diçka publike që me thanë na e bonëm këtë, e ndihmum këtë. E ajo është ajo ndihma e vërtetë se diku në Bibël shkruan, "Çfarë bën e djathta... mos ta dijë e majta çfarë bën e djathta". Po na njerz të jemi njerëz, e kemi nganjëherë qejf, sikur unë që u lavdrova këtu u knaqa (qeshë). Jo, nuk u lavdërova.

Anita Susuri: Nëse keni edhe diçka me shtu për fund?

Greta Kaçinari: Për fund...

Anita Susuri: Nëse keni harru diçka apo...

Greta Kaçinari: A t'ju thrrasë nesër? (qeshë) Jo, nuk kam harru po nuk i kam prekë të gjitha, normal. Nuk e kam prekë atë ma kryesore të jetës bashkëshortore.

Anita Susuri: Po.

Greta Kaçinari: Si ka ardhë deri te ajo që nuk ka qenë vetëm shikimi, dashnia në shikim të parë por ka qenë edhe një planifikimi i ma hershëm i dëshirave. Pasi jetoja në Bosnje ishte, dua të martohem për shqiptar, dua të martohem prej Prizreni që kur të përlehemi mos ta shaj prej cilës vendlindje po vjen. Dua të jetë i shkolluar, se kisha plot asi që kërkonin dorën time e ishin ksi argjentare ose zanatli. E unë doja të jetë i shkolluar. Bile njëri më pat shajhtë, “A e kreve ma atë shkollë?” E pat shajhtë shkollën. Ashtu që, është prej krejt këtyre të gjitha m'u plotësuan, se edhe i doja vet edhe është ai, ajo që i lidh njerëzit për diçka.

Edhe t'ju them edhe diçka këtu se në Letnicë e kishim natën e fundit, qysh i thojnë shqip? *Dame biraju*, zonjat zgjedhin për vallëzim. Edhe vallëzimi i parë e ka shpërblimin pesë minuta me shkue në arë me grurë, me misër, misri ishte i ngritur, se atje në katun krejt ara përreth shtëpive. Dhjetë minuta shpërblimi i parë i dyti s'di cili ka qenë. E mbaj mend të parin sepse i kemi fitue dhjetë minuta. Por unë kam zgjedhë Gjergjin për vallëzim. Por ma vonë kemi vazhdue grumbull ashtu siç kemi qenë njëqind e ca të rinjë, kemi vazhdue në Prizren ditëve të ardhshme edhe kështu. Atë ditë ka pasë shumë martesat të atyre që janë takue qoftë për herë të parë, qoftë për disa herë ma vonë.

Me randësi është që kur i kam thanë, kur kam fillu të mendoj rreth Gjergjit ato ditë që ishim në Letnicë. Baba thotë, “Kush është bre ai djalë i ri? Diçka po m'pëlqen”, “*Hmmm* {onomatope} e ku e dite që po t'pëlqen? Ku e dite?” (qeshë). Bash ai. Edhe ja kështu. Pos këtyre katër dëshirave, jeta po sjellke edhe shumë gjana tjera. Edhe me randësi është respekti, mos përzierja shumë në punët e brendshme të individit. Se kjo në të vërtetë shkakton ma së shumti probleme edhe që njeriu ta çoi deri në fund atë fjalën që e jep në të mirë e në të keqe deri në fund. Unë u përpoqa ta bëj këtë deri në fund dhe ia kam dalë deri në fund.

Dhe ajo çfarë ishte shok për mua ishte kur në komunë shkova t'i kryej disa dokumente. Më tha, “Zojë tash ligjërisht jeni e shkurorëzuar”. “Çka? Kush ka të drejtë të më shkurorëzoj mua?” Ishte një reagim impulsiv, saqë disa burra që ishin pas meje mbetën edhe ata të shokum. “Kush ka të drejtë mua ligjërisht të më shkurorëzoj?” (qeshë) Atëherë kur e mendova derisa vdekja t'nuk na ndajë. E qikjo është kjo, por ishin momente shumë emocionuese edhe unë vështirë i përballova.

Kjo krejt ndodhi para se t'na vjen vizitori më i ri në Kosovë edhe më i rrezikshmi deri më tani. Ky është, kjo është kjo pandemi që e tjetërsoi, e tjetërsoi, e ndryshoi, e tjetërsoi krejt jetën e përditshme të çdo njeriu të gjallë në këtë Kosovë. Mendoj, se pas përpjekjeve të shumta për vetëdijësim të popullatës është arritë një nivel i duhur. Jo që e kanë ba politikanët këtë, por popullata vetë mes vete.

Për shkak se është turp që një këngëtar i njohur të del me një deklaratë se... të cilin e konsiderojmë njeri të përgjegjshëm se është edhe anëtar i kuvendit, a është ende? Nuk e di. Por së paku ka qenë deputet. Por, sidoqoftë ka një emër edhe t'i lejoj vetit të thotë, "Nuk ka [virus]". Ai ka mund të thotë, "Në emër të vetëvetit unë nuk e kam. Por nuk jam i sigurt plotësisht". Ashtu si as unë sot nuk jam e sigurt a e kam a nuk e kam. As ju të dyja nuk jeni të sigurt.

Domethanë, kur t'u futet pasiguria në një vend ai vend fillon të bëhet shumë i ndjeshëm. Unë lus Zotin që vetëm gjeneratat e reja ta gjejnë rrugën edhe ta kuptojnë se do të ballafaqohen me ndryshime shumë të mëdha, për të cilat ne të vjetërit nuk jemi të përgatitur. Ama, as nuk do t'kemi mundësi të përgatitemi se i tejkalon njohuritë tona, fuqitë tona mendore. Por që të rinjtë sa ma herët këtë ta kuptojnë. Jeta që ju pret juve edhe të gjithë të rinjtë që vijnë pas kurrë ma nuk ka me qenë e njejtë si ka qenë dikur.

Domethanë, adaptimi është mëse i nevojshëm e më së shumti është që duhet të rinjtë të mësojnë shumë, shumë të mësojnë. T'i mësojnë gjuhtë e huaja, kjo është e para edhe është më e rëndësishmja, krejt të tjerat vijnë pas. Sepse përmes gjuhëve ju do t'mund të hyni në botën virtuale, në botën e teknologjisë së re e kjo është e ardhmja. Domethanë, ju jeni Alfa. A e dini këtë ndarje të gjeneratave?

Anita Susuri: Po e di, sipas amerikanëve që e kanë nda.

Greta Kaçinari: Edhe shumë interesante. Jo vetëm amerikanët, e kanë ba edhe rustë edhe evropianët edhe secili, shumë interesant. Por aty janë përafërsisht të gjithë janë diku te një nivel. Unë juve si *Alpha Generation*, si gjeneratë e alfës apo edhe gjeneratë e zetit, e Z-së, mund të jeni ju të Z-së, se jeni lind...

Anita Susuri: Gjatë viteve të '90-ta.

Greta Kaçinari: Po. Por ajo hyn pak edhe deri në 2010-shën m'duket Zë-ja e pastaj vjen Alfa. E Alfa është në alfabetin grek shkronja e parë. Alfa përdoret si fillim i ri, Alfa është diçka që mbin, mbinë e re. Andaj, knaqësia ishte e imja që ju kisha këtu në banesën time edhe kënaqësi ma e madhe ishte që të dyja jeni vajza, jeni femra edhe që po mirreni me këso punësh edhe shumë interesante edhe më duket paksa të rëndësishme. Mos harroni që krejt këto histori që i keni, i keni krye deri më tash, histori të njerëzve që kanë jetue apo jetojnë në një periudhë të caktuar t'i fusni diku që ndonjëherë ndonjë virus mos t'i dëmtoj.

Anita Susuri: Faleminderit shumë, zonja Gretë.

Greta Kaçinari: Juve ju faleminderit, të dyjave.